

UDHËZIM
Nr. 4, datë 25.8.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE EKOLOGJIKE PËR DHËNIEN E EKOETIKETËS
PËR PRODUKTET TEKSTILE***

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 4, të kreut II, të VKM-së nr. 220, datë 11.3.2015, “Për miratimin e procedurës dhe kriterëve për pajisjen me ekoetiketë, mënyrën e përdorimit dhe vlefshmërinë e saj, dhe përbërjen e funksionimit të komisionit për lëshimin e eko-etiketës”,

UDHËZOJMË:

1. Miratimin e kriterëve ekologjike për dhënien e ekoetiketës për grupin e produktit “produkte tekstile”.
2. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë kuptimet si më poshtë vijon:
 - a) Grupi i produktit “produkte tekstile” do të përfshijë:
 - i) veshje tekstile dhe aksesorë: veshje dhe tekstile që konsistojnë në të paktën 80% fibra tekstile në peshë, në një formë të thurur, jo të thurur ose të punuara me shtizë;
 - ii) tekstile të brendshme: produkte tekstile për përdorim të brendshëm që konsistojnë në të paktën 80% fibra plastike në peshë, në një formë të thurur, jo të thurur ose të punuara me shtizë;
 - iii) fibra, fije, pëlhurë ose panele të thurura (të punuara me shtizë): të destinuara për përdorim në veshje tekstile dhe aksesorë dhe tekstile të brendshme, duke përfshirë pëlhurë tapicerie dhe pëlhurë dyshekësh përpara aplikimit të mbështetjes/shpinës dhe trajtimeve të shoqëruara me produktin final/përfundimtar;
 - iv) elemente pa fibra: zinxhirë, kopsa dhe aksesorë të tjerë që janë inkorporuar në produkt. Membrana, veshje dhe laminat (fletë plastike);
 - v) produktet e pastrimit: produkte pëlhurë të punuara ose jo të punuara, të destinuara për pastrimin e thatë apo të lagët të sipërfaqeve dhe tharjen e enëve të gatimit.
 - b) “Fibrat tekstile” janë fibrat natyrale, fibrat sintetike dhe fibrat celuloze të bëra nga njerëzit;
 - c) “Fibra natyrale” janë pambuku dhe fara fibrash celuloze ose të tjera, fibra me fije liri ose të tjera prej lëvoreje bliri, fibra leshi dhe të tjera keratine;
 - d) “Fibra sintetike” janë akrilik, elastane, poliamid, poliestër dhe polipropilen;
 - e) “Fibra celuloze” të bëra nga njerëzit janë lyocell, modale dhe vizkoze (fije mëndafshi).
3. Produktet e mëposhtme nuk janë përfshirë në grupin e produktit “produkte tekstile”:
 - a) produktet të destinuara për asgjësim pas një përdorimi të vetëm;
 - b) mbulesat e dyshemeve, jo në konform me legjislacionin në fuqi;
 - c) pëlhura që përbëjnë pjesë të strukturave të destinuara për përdorim të jashtëm.
4. Veshje, pëlhura dhe fibra që përmbajnë sa më poshtë janë përjashtuar nga grupi i produktit:
 - a) pajisjet elektrike ose të cilat përbëjnë një pjesë integrale të qarkut elektrik;
 - b) pajisje ose substanca të ngopura, të projektuara për të ndjerë apo reaguuar ndaj ndryshimeve në kushte ambienti.
5. Për mbushje, astarët, material mbushës, membrana dhe veshje të përbëra nga fibra, të “veshjeve tekstile dhe aksesorëve” dhe “tekstilet e brendshme”, të përfshira në qëllimin e këtij udhëzimi, nuk kanë nevojë të merren në konsideratë në llogaritjet e përqindjes të fibrave tekstile.
6. Materialet mbushëse, të cilat nuk janë përbërë nga fibrat plastike duhet të përputhen me kufizimet e renditura në kriterin 10 të përcaktuar në shtojcën që lidhet me pjesët ndihmëse, surfkatantët, biocidet dhe formaldehidet.
7. Kriteret për dhënien e ekoetiketës, për një produkt që bie në grupin e produktit “produkte tekstile”, të përcaktuar në pikën 2/a të këtij udhëzimi, si edhe kërkesat përkatëse të vlerësimit dhe verifikimit janë përcaktuar në shtojcë.
8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Komisioni Shtetëror për Dhënien e Ekoetiketës.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

* Ky draftudhëzim transponon pjesërisht vendimin e Komisionit Evropian, datë 5 qershor 2014, “Për përcaktimet e kriterëve ekologjike për dhënien e ekoetiketës BE për produktet tekstile”, 2014/350/BE, CELEX 32014D0350, OJ L 174, f. 45–83.

SHTOJCA

Kriteret për dhënien e ekoetikës për produktet tekstile dhe nënkategoritë nën të cilat ato janë grupuar, janë si më poshtë:

Fibrat tekstile

1. Pambuk dhe fibra bërthamë/farë celuloze natyrale të tjera.
2. Fije liri dhe fibra të tjera me lëvore bliri.
3. Lesh dhe fibra të tjera keratine.
4. Akrilik.
5. Elastane (një material elastik poliuretani).
6. Poliamid.
7. Poliestër.
8. Polipropilen.
9. Fibra celuloze të bëra nga njerëzit (lyocell, modale dhe vizkoze).

Komponentët dhe aksesorët

10. Mbushje.
11. Veshje, laminate dhe membrana.
12. Aksesorët.

Kimikatet dhe proceset

13. Lista e substancave të kufizuara (RSL).
14. Zëvendësimi i substancave të rrezikshme në lyerje, stampim dhe përfundim (lustër).
15. Larje, tharje dhe konservimin e efikasitetit të energjisë.
16. Trajtimin e emetimeve në ajër dhe ujë.

Të përshtatshme për përdorim

17. Ndryshimet dimensionale gjatë larjes dhe tharjes.
18. Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj larjes.
19. Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj perspirimit (acid, alkaline).
20. Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit të lagësht.
21. Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit të thatë.
22. Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës.
23. Rezistenca e larjes të produkteve të pastrimit.
24. Rezistenca e pëlhurës ndaj krijimit të gungave dhe konsumimit (abrazionit).
25. Qëndrueshmëria e funksionimit.

Përgjegjësia sociale e korporatës

26. Parimet themelore dhe të drejtat në punë.
27. Kufizimi i *sandblasting* (ajër me rërë) të xhinseve.

Informacion mbështetës.

28. Informacioni që shfaqet në ekoetiketë

Shtojca 1, për më tepër, përmban RSL-në e referuar në kriterin 13. Këto kufizime të kësaj liste zbatohen për substancat e rrezikshme, që mund të përdoren për të prodhuar produktet tekstile dhe të cilat mund të përmbahen në produktin përfundimtar.

Kriteret e ekoetiketës reflektojnë produktet me performancën më të mirë mjedisore në tregun e tekstileve. Ndërsa përdorimi i produkteve kimike dhe shkarkimi i ndotësve është pjesë e procesit të prodhimit, një produkt që mban ekoetiketën garanton konsumatorin që përdorimi i substancave të tilla është kufizuar në maksimumin e mundshëm teknik pa cenuar përshtatshmërinë për përdorim.

Kriteret përjashtojnë sa herë që është e mundur ose kufizojnë në minimum përqendrimin (e kërkuar për të ofruar funksione dhe veçori /karakteristika specifike) të një numri substancash të identifikuara si të rrezikshme ose potencialisht të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe mjedisi që mund të përdoret për të prodhuar tekstilet. Vetëm kur njësubstancë kërkohet që të përmbushë pritshmëritë e performancës të konsumatorit ose kërkesat që kanë një mandat për produktin (për shembull, ngadalësimi i

flakës) dhe kur nuk ka alternativa të disponueshme të testuara ose të zbatuara, jepet përjashtimi i një substance të tillë që të përdoret në ekoetiketë.

Përjashtimet janë vlerësuar në bazë të parimit parandalues dhe evidencave shkencore dhe teknike, veçanërisht nëse në treg ka të disponueshme produkte më të sigurta.

Testimi i produkteve për substancat e rrezikshme të kufizuara, kërkohet në mënyrë që të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë për konsumatorët. Kushte të rrepta janë vendosur, gjithashtu, për proceset e prodhimit për tekstilet, për të kontrolluar ndotjen e ujërave dhe ajrit dhe për të minimizuar ekspozimin e forcës punëtore. Verifikimi i përputhshmërisë me kriteret është formuluar në mënyrë të tillë që siguron një nivel të lartë sigurie për konsumatorët, reflekton potencialin praktik për aplikantët, për të marrë informacion nga zinxhiri i furnizimit dhe përjashton potencialin për “udhëtim të lirë” nga aplikantët.

Vlerësimi dhe verifikimi

Në mënyrë që të tregohet përputhshmëri me kriteret, aplikantit i kërkohet që të deklarojë informacionin e mëposhtëm rreth produktit (produkteve) dhe zinxhirin e tyre të furnizimit:

Tabela 1

Pamje e përgjithshme e kërkesave të vlerësimit dhe verifikimit

Kriteret e përcaktuara	Burimi i verifikimit
a) Kriteri i fibrave tekstile: përbërja e plotë e materialit të produktit (produkteve), duke identifikuar dhe duke treguar përputhshmëri për fibrat tekstile, komponentët dhe aksesorët.	Prodhuesit e fibrave dhe komponentëve, materiali i lëndës së parë i tyre dhe furnizuesit kimik dhe laboratorët e testimit që punojnë në përputhje me metodat specifike të testimit.
b) Kimikatet dhe proceset: substancat, recetat e prodhimit dhe teknologjitë e përdorura për të prodhuar dhe dhënë cilësi dhe funksione specifike të produktit në fazat e tjerjes, paratrajtit, lyerjes/ngjyrosjes, stampimit dhe përfundimit dhe për të trajtuar emetimet e ajrit dhe ujërave të ndotura.	Vendndodhjet e prodhimit, furnizuesit e tyre kimikë dhe laboratorët e testimit, që punojnë në përputhje me metodat specifike të testimit. Kur kërkohet, testimi analitik i produktit do të kryhet çdo vit, gjatë periudhës së licencës dhe t'i dorëzohet organit kompetent të duhur për verifikim.
c) Përshtatshmëria për përdorim: performanca e produktit (produkteve), siç është përkufizuar nga procedurat specifike të testimit, të cilat adresojnë fortësinë e ngjyrës nën kushtet specifike, rezistencën ndaj gungave dhe konsumimit dhe qëndrueshmërinë e funksioneve të rezistencës, mirëmbajtjes së lehtë dhe ngadalësimin e flakës.	Laboratorët e testimit që punojnë në përputhje me metodat specifike të testimit.
d) Përgjegjësia sociale e korporatës: përputhshmëria e furnizuesve, për prerje/bërje/shkurtim, të zgjedhur nga aplikanti me standardet e përcaktuara ILO.	Verifikues të pavarur ose evidencë e dokumentuar bazuar në auditimin e vendndodhjeve të prodhimit të prerjes/bërjes/ përshtatjes.

Secili kriter përmban kërkesa verifikimi të detajuara, të cilat i kërkojnë aplikantit të hartojë deklarata, dokumentacion, analiza, raporte testesh dhe evidenca të tjera, në lidhje me produktin (produktet) dhe zinxhirin e tyre të furnizimit.

Vlefshmëria e licencës është bazuar në verifikimin mbi aplikimin dhe, kur specifikohet në kriterin 13, në testimin e produkteve, të cilat do t'u dorëzohen organeve kompetente për verifikim. Ndryshimet e furnizuesve dhe vendndodhjeve të prodhimit, që i përkasin produkteve të licencuara, do t'i njoftohen organeve kompetente, së bashku me informacion mbështetës për të verifikuar përputhshmërinë në vazhdim me kushtet e licencës.

Organet kompetente, në mënyrë preferenciale, do të njohin testimet nga laboratorët, të cilët janë akredituar në përputhje me ISO 17025 dhe verifikimet e kryera nga organet të cilat janë akredituar sipas standardit EN 45011 ose një standard kombëtar ekuivalent.

Njësia e funksionimit, me të cilën duhet të lidhen inputet (hyrjet) dhe outputet (prodhimet), është 1 kg produkt tekstil në kushte normale (65% RH ± 4% dhe 20°C ± 2°C; këto kushte normative janë specifikuar në tekstilet ISO 139 – atmosferat standarde për kushtet dhe testimin).

Kur aplikanti përdor një sistem certifikimi, për të siguruar verifikime të pavarura, sistemi i zgjedhur

dhe sistemet e shoqëruara të verifikuesve do të përmbushin kërkesat e përgjithshme të EN 45011 dhe ISO 17065. Kur është e përshtatshme, organet kompetente mund të kërkojnë dokumentacion mbështetës dhe mund të kryejnë verifikime të pavarura dhe vizita në vendndodhje.

Organet kompetente janë rekomanduar që të marrin në konsideratë implementimin e skemave të njohura të menaxhimit mjedisor, të tilla si: EMAS, ISO 14001 dhe ISO 50001, kur janë duke vlerësuar aplikimet dhe monitoruar përputhshmërinë me kriteret (shënim: nuk është e kërkuar të implementohen skema menaxhimi të tilla).

KRITERET E EKOETIKETËS

Aplikantët do të vërtetojnë përputhshmërinë me kriteret përsa i përket përbërjes së materialit, formulimeve kimike, vendndodhjeve të prodhimit dhe përshtatshmërisë për përdorim të produkteve që ato dëshirojnë që të mbajnë një ekoetiketë.

1. KRITERET E FIBRAVE TEKSTILE

Kriteret specifike për fibrat janë përcaktuar në këtë seksion për llojet e mëposhtme të fibrave:

a) Fibrat natyrore: pambuk dhe fara/bërthama fibrash celuloze natyrore të tjera, fije liri dhe fibra të tjera prej lëvoreje bliri, lesh dhe fibra të tjera keratine;

b) Fibrat sintetike: akrili, elastane, poliamid, poliestër dhe polipropilen;

c) Fibra celuloze të bëra nga njerëzit: lyocell, modale dhe vizkoze. Kriteret për një lloj të caktuar fibre, nuk kanë nevojë të përmbushen, nëse një fibër kontribuon në më pak se 5% të peshës totale të produktit ose nëse ato përbëjnë një material mbushës ose astar. Me përjashtim të poliamidës dhe poliestrës, këto kritere nuk kanë nevojë të përmbushen:

a) Nga i gjithë produkti, nëse ai përmban fibra që përmbajnë përbërje të ricikluar, që përbën të paktën 70% në peshë të të gjitha fibrave në produkt;

b) Nga fibrat individuale që përbëjnë pjesë të produktit të ekoetiketuar, i cili përmban të paktën 70% në peshë të përmbajtjes së ricikluar.

Në këtë kontekst, fibrat që përmbajnë një përmbajtje të ricikluar, janë përkufizuar si fibra që e kanë origjinën nga mbetje parakonsumatore (duke përfshirë mbetjet e prodhimit të polimerit dhe fibrave, prodhuesit e prerjeve nga tekstilet dhe veshjeve) dhe mbetjet paskonsumatore (tekstilet dhe të gjitha llojet e produkteve me fibra dhe tekstile, si edhe mbeturina jotekstile që përfshijnë shijet e pijeve PET dhe rrjetat e peshkimit).

Përmbajtja e ricikluar, me përjashtim të shisheve PET, të përdorura për të prodhuar poliestër, do të përmbushin kërkesat e kriterit 13 të listës së substancave të ndaluara. Kjo do të përfshijë testime analitike vjetore josistematike për grupe specifike substancash.

Vlerësimi dhe verifikimi për përmbajtjen e ricikluar: përmbajtja e ricikluar do jetë e gjurmueshme në ripërpunimin e lëndës së parë. Kjo do të verifikohet nga certifikimi i palëve të treta të pavarura për zinxhirin e ruajtjes /kujdestarisë ose nga dokumentacioni i siguar nga furnizuesit dhe ripërpunuesit e lëndës së parë. Kur kërkohet nga kriteri 13, rezultatet e testimit laboratorik dhe deklaratat do të sigurohen nga prodhuesit e fibrave dhe furnizuesit e lëndës së parë.

Kriteri 1. Pambuku dhe fara fibrash celuloze natyrore të tjera (duke përfshirë kapok)

- Pambuku dhe fara fibrash celuloze natyrore të tjera (këtu e më poshtë referuar si pambuk) do të përmbajë një përmbajtje minimale ose të pambukut organik (shih kriterin 1.a) ose pambuk për menaxhimin e integruar të insekteve (IPM) (shih kriterin 1.b). Përveç kësaj:

- I gjithë pambuku konvencional dhe pambuku IPM do të jenë në përputhshmëri me kufizimet e pesticideve në kriterin 1.c;

- Për standardin e prodhimit 1 (a) organike, i gjithë pambuku konvencional dhe pambuku IPM i përdorur do të vijë nga varietete jo të modifikuara gjenetiki;

- I gjithë pambuku organik dhe IPM do të jetë plotësisht i gjurmueshëm në përputhje me kriterin 1.d;

- Veshjet për foshnjat më të vogla se 3 vjeç do të përmbajnë një minimum prej 95% pambuk organik.

Produktet që përmbushin kufijtë specifike të përmbajtjes për pambuk organik ose IPM do të lejohen që të shfaqin tekst shtesë, krahas ekoetiketës, duke komunikuar udhëzimin në lidhje me përmbajtjen. Ofrohet udhëzim në kriterin 28.

1.a) Standardi i prodhimit organik

Me përjashtim të produkteve, të renditura nën një minimum prej 10% të pambukut, do rriten në

përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Përbërja e pambukut organik mund të përfshijë pambuk të rritur organikisht dhe pambuk organik të përkohshëm.

Përmbajtja e pambukut, e produkteve të mëposhtme, do të përmbajë një minimum prej 95% pambuk organik: bluza/këmisha, bluza për femra, bluza të përditshme, xhinse, pizhame dhe veshje për natën, të brendshme dhe çorapë.

Vlerësimi dhe verifikimi: përmbajtja organike duhet të certifikohet nga një organ kontrollues i pavarur, që është prodhuar në konformitet me kërkesat e prodhimit dhe inspektimit, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi. Verifikimi do të sigurohet në baza vjetore për çdo shtet origjine.

Varietetet jogjenetikisht të modifikuara të pambukut do të verifikohen në konformitet me legjislacionin kombëtar në fuqi.

1.b) Prodhimi i pambukut në përputhje me parimet IPM

Një minimum prej 20% e pambukut, do të rritet në përputhje me parimet IPM dhe do të jenë në përputhshmëri me kufizimet e pesticideve në kriterin 1 (c).

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë evidencë që pambuku është rritur nga fermerë që kanë marrë pjesë në programet e trajnimeve formale të UN FAO ose qeveritare IPM dhe programet ICM dhe/ose janë audituar si pjesë e skemave IPM të certifikuara nga palë të treta. Verifikimi ose do të sigurohet mbi baza vjetore për çdo shtet origjine ose në bazë të certifikimeve për të gjitha paketimet/dengjet e pambukut IPM të blera për të prodhuar produktin.

Përputhshmëria me kufizimet e pesticideve nuk do të kërkohet për skemat, të cilat ndalojnë përdorimin e substancave të renditura në kriterin 1(c), dhe kur, ose është kryer testimi ose janë siguruar deklaratat për mospërdorim nga fermerët dhe/ose grupet e prodhimit të fermerëve, që janë verifikuar nga vizitat në vendndodhje, të kryera nga organet e kontrollit të akredituar ose nga qeveritë kombëtare ose organike të njohura, ose skemat e certifikimit IPM.

Pambuku IPM jogjenetikisht i modifikuar, i përdorur në kombinim me pambukun organik do të verifikohet në konformitet me legjislacionin në fuqi. Skemat IPM, që përjashtojnë pambukun e modifikuar gjenetikisht, do të pranohen si provë e përputhshmërisë për përmbajtjen IPM.

1.c) Kufizimet e pesticideve që zbatohen për pambukun konvencional dhe IPM

I gjithë pambuku i përdorur në produktet tekstile të ekoetiketuara, me përjashtim të pambukut organik dhe pambukut nga skemat IPM, të përjashtuar në 1(b), do të rriten pa përdorimin e asnjë prej substancave të mëposhtme:

Alaklor, aldcarb, aldrin, campheclor (toxafene), captafol, klordane, 2,4,5-T, klordimeform, klorobenzilate, cypermethrin, DDT, dieldrin, dinoseb dhe kripërat e tij, endosulfan, endrin, glyphosulfate, heptachlor, hexachlorobenzene, hexachlorocyclohexane (izomerët total), methamidophos, methyl-o-dematon, methylparathion, monocrotophos, neonicotinoids (clothianidine, imidacloprid, thiametoxam), parathion, phosphamidon, pentachlorophenol, thiofanex, triafanex, triazophos.

Pambuku nuk do të përmbajë më shumë se 0,5 ppm në total të substancave të renditura më poshtë.

Vlerësimi dhe verifikimi: pambuku do të testohet për substancat e renditura. Një raport testimi do të sigurohet në bazë të metodave të mëposhtme të testimit, si të jetë e përshtatshme:

- US EPA 8081 B (pesticidet organo-klorur, me ekstraktim ultrasonik ose soxhlet dhe solventë apolar (iso-octane ose hexane);

- US EPA 8151 A (herbicide të klorinuara, duke përdorur metanol);

- US EPA 8141 B (komponime organo-fosforike);

- US EPA 8270 D (komponime organike gjysmë të paqëndrueshme).

Testimet do të bëhen mbi mostra të pambukut të papërpunuar nga çdo shtet origjine dhe përpara se ai të kalojë në ndonjë trajtim të lagësht. Për çdo shtet origjine, testimi do të kryhet mbi bazat e mëposhtme:

i) kur përdoret vetëm një parcelë pambuku në vit, një mostër do të merret nga një paketim/deng i zgjedhur rastësisht;

ii) nëse përdoren dy ose më shumë parcela pambuku në vit, mostra të përbëra do të merren nga 5% e paketimeve/dengjeve.

Pambuku nuk është kërkuar të testohet kur ai është certifikuar nga një skemë IPM që ndalon përdorimin e substancave të renditura.

1.d) Kërkesat e gjurmueshmërisë që zbatohen për pambukun organik dhe IPM.

I gjithë pambuku, i rritur në përputhje me standardet e prodhimit organik dhe IPM dhe të përdorur për të prodhuar një produkt tekstil të ekoetiketuar, do të jetë i gjurmueshëm nga pika e verifikimit e standardit të prodhimit deri në, si një minimum, prodhimin e pëlhurës gri.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të vërtetojë përputhshmëri me kërkesën e përmbajtjes minimale të pambukut ose për volumin vjetor të pambukut të blerë ose për përzierjen e pambukut, e përdorur për të prodhuar produktin (produktet) dhe në përputhje me çdo linjë produkti:

i) mbi baza vjetore: do të ofrohen të dhënat e transaksionit dhe/ose faturat që dokumentojnë sasinë e pambukut të blerë në baza vjetore nga fermerët ose grupet e prodhimit dhe/ose peshën totale të paketimit/dengut të certifikuar, deri në prodhimin e pëlhurës gri;

ii) mbi baza të produktit përfundimtar: do të ofrohet dokumentacion nga tjerrija dhe ose fazat e prodhimit të pëlhurës. I gjithë dokumentacioni do të referojë organin e kontrollit ose certifikuesin e formave të ndryshme të pambukut.

Kriteri 2. Fije liri dhe fibra të tjera prej lëvoreje bliri (duke përfshirë kërp, jute dhe rami)

2.a) Fijet e lirit dhe fibra të tjera prej lëvoreje bliri do të njomen në kushte ambienti dhe pa inputin e energjisë termike.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një deklaratë për metodën e njomjes të përdorur nga fermeri dhe/ose fabrikat e zhveshjes së pambukut që furnizojnë fibra.

2.b) Kur përdoret ujë për njomje, uji i ndotur nga pellgjet e njomjes do të trajtohet në mënyrë që të reduktojë COD-në ose TOC-në me të paktën 75% për fibrat e kërpit dhe me të paktën 95% për fijet e lirit dhe fibra të tjera prej lëvoreje bliri.

Vlerësimi dhe verifikimi: nëse është përdorur njomje me ujë, aplikanti do të ofrojë një raport testimi që tregon përputhshmërinë dhe që përdor metodat e mëposhtme të testimit: ISO 6060 (COD).

Kriteri 3. Leshi dhe fibra të tjera keratine (duke përfshirë leshin nga delja dhe qengjat dhe qimet e devesë, alpaca dhe dhisë)

3.a) Shumat totale, të ofruara në tabelën 2, nuk do të tejkalohen për përqendrimit ectoparazitike të leshit të papërpunuar përpara pastrimit.

Këto kërkesa nuk do të zbatohen nëse mund të paraqitet evidencë e dokumentuar që përcakton identitetin e fermerëve që prodhojnë të paktën 75% të leshit dhe fibrave keratine në fjalë, së bashku me një verifikim të pavarur të bazuar në vizitat në vendndodhje që substancat e renditura më lart nuk janë zbatuar për fushat apo kafshët në fjalë.

Tabela 2

Kufizimet e shumës totale për përqendrimit ectoparazitike në lesh

Grupet ectoparazitike	Vlera kufi e shumës totale
γ -hexachlorocyclohexane (lindane), α -hexachlorocyclohexane, β -hexachlorocyclohexane, δ -hexachlorocyclohexane, aldrin, dieldrin, endrin, p,p'-DDT, p,p'-DDD	0,5 ppm
Cypermethrin, deltamethrin, fenvalerate, cyhalothrin, flumethrin	0,5 ppm
Diazinon, propetamphos, chlorfenvinphos, dichlofenthion, chlorpyrifos, fenclorophos	2 ppm
Diflubenzuron, triflumuron, dicyclanil	2 ppm

Burimet e leshit që operojnë sisteme uji me lak të mbyllur, pa shkarkimin e rrjedhjeve të ujërave të ndotura (ujëra të zeza) dhe të cilat thyejnë ectoparazitikët e lartpërmendur, që mund të jenë të pranishëm në mbetjet e pastrimit dhe llumrat nëpërmjet djegies, janë përjashtuar nga kërkesa për testimin e leshit, por duhet të përputhen me të paktën dy nga masat në 3 (c).

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti ose do të ofrojë dokumentacionin e treguar më lart ose do të hartojë raporte testimesh, duke përdorur metodat e mëposhtme të testimit: metoda 95 draft e testit IWTO. Testimi duhet të bëhet në sasinë e shitjes të leshit të papërpunuar, nëpërmjet shteteve të origjinës (nëse janë përzier) dhe përpara përpunimit të lagësht. Një minimum prej një mostër të përbërë, e shumë parcelave nga çdo shtet origjinë, do të testohet për parcelë përpunimi. Një mostër e përbërë duhet të konsistojë në:

i) Fibra leshi nga të paktën 10 parcela fermerësh, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, brenda parcelave të shitjes; ose

ii) Një mostër të përbërë për fermer, që furnizon parcelat kur ka më pak se 10 parcela brenda parcelës së përpunimit.

Në mënyrë alternative, certifikatat e testimi të mbetjeve mund të dorëzohen për të gjitha parcelat e shitjes në një parcelë përpunimi.

Kur zbatohet një përjashtim, aplikanti do të ofrojë evidencë duke konfirmuar konfigurimin e pastrimit të bimës dhe raportet e testeve laboratorike, duke vërtetuar ndarjen e ektoparazitikëve që mund të jenë të pranishëm në mbetjet dhe llumrat e pastrimit.

3.b) Operacionet e pastrimit të leshit do të minimizojnë rrjedhjet COD duke maksimizuar heqjen e pisllekut dhe rikuperimin e yndyrave, të ndjekur nga trajtimi në vlerën e specifikuar në tabelën 3 ose në ose jashtë vendndodhjes. Limitet e mëposhtme COD do të zbatohen për pastrimin e yndyrave të leshit të trashë dhe leshit delikat. Leshi delikat është përkufizuar si leshi merino prej $\leq 23,5$ micron në diametër.

Tabela 3

Vlerat COD për shkarkimin përfundimtar të rrjedhjeve nga pastrimi i leshit

Lloji i leshit	Shkarkimi përfundimtar në mjedis (g COD/kg yndyrë leshi)
Lesh i trashë	25 g/kg
Lesh delikat	45 g/kg

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë të dhëna përkatës dhe raporte testesh në lidhje me këtë kriter, duke përdorur metodën e mëposhtme të testimi: ISO 6060. Të dhënat do të demonstrojnë përputhshmëri nga vendndodhje e pastrimit të leshit ose në rrjedhjet trajtohen përtej vendndodhjes, nga operatori i trajtimit të ujërave të ndotura. Përputhshmëria me këtë kriter do të jetë në bazë të mesatares mujore për gjashtë muaj që i paraprijnë aplikimit.

3.c) Pastruesit e leshit do të implementojnë të paktën një nga masat e mëposhtme për të rikuperuar vlera ose nga yndyra, fibra, suinttë oksiduar ose nga llumra që dalin nga vendndodhja e pastrimit, të përdorur për produktet e leshit të ekoetiketuara:

- i) rikuperimi për shitje si një lëndë e parë kimike;
- ii) prodhimi i kompostit ose fertilizuesit të lëngshëm;
- iii) prodhimi i produkteve të tilla si materialet e ndërtimit;
- iv) trajtimi dhe rikuperimi i energjisë nga tretja anaerobike ose djegia (incinerimi).

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një raport dhe shënimet për transferimin e mbetjeve/mbeturinave, duke konfirmuar llojin dhe raportin e mbetjeve të rikuperuara dhe metodën e përdorur.

Kriteri 4. Akriliku

4.a) Emetimet në ajër të akrilonitrileve (gjatë polimerizimit dhe deri në tretësirën gati për tjerje), të shpehur si një mesatare vjetore, do të jetë më pak se 1,0 g/kg të fibrave të prodhura.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë dokumentacion të detajuar dhe/ose raportet e testeve, duke treguar përputhshmëri me këtë kriter, sëbashku me një deklaratë përputhshmërie nga prodhuesi (prodhuesit) e fibrave.

4.b) Emetimet në vendin e punës në ajër të N,N-dimetilacetamidës (127-19-5) gjatë polimerizimit dhe tjerjes, nuk do të tejkalojnë një vlerë limit të ekspozimit në punë (IOELV) prej 10,0 ppm.

Vlerësimi dhe verifikimi: vlerat e emetimit do të maten në ato faza procesi, në të cilën janë përdorur substancat, të shprehur si një vlerë mesatare 8 orë (vlera mesatare e turnit). Aplikanti do të ofrojë raporte testimesh dhe të dhëna monitorimesh nga prodhuesi (prodhuesit) e fibrave që tregojnë përputhshmëri me këtë kriter.

Kriteri 5. Elastane (një material elastik poliuretani)

5.a) Komponentet organotin nuk do të përdoren për të prodhuar fibra.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një deklaratë për mospërdorim nga prodhuesi (prodhuesit) e fibrave.

5.b) Emetimet në vendin e punës në ajër, të substancave të mëposhtme, gjatë polimerizimit dhe tjerjes nuk do të tejkalojnë vlerat limit të ekspozimit në punë (IOELV) të mëposhtme:

- i) diphenylmethane-4,4'-diisocyanate (101-68-8) 0,005 ppm;
- ii) toluene-2,4-diisocyanate (584-84-9) 0,005 ppm;
- iii) N,N-dimethylacetamide (127-19-5) 10,0 ppm.

Vlerësimi dhe verifikimi: vlerat e emetimit do të maten në ato faza procesi, në të cilën janë përdorur substancat, të shprehur si një vlerë mesatare 8 orë (vlera mesatare e turnit). Aplikanti do të ofrojë raporte testimesh dhe të dhëna monitorimesh nga prodhuesi (prodhuesit) e fibrave që tregojnë përputhshmëri me këtë kriter.

Kriteri 6. Poliamid (ose najlon)

Produktet poliamid do të përputhen me të paktën një nga standartet e prodhimit të renditura në nënkriterin 6(a) dhe 6(b). Çdo produkt, që përmbush prapën minimal të përmbajtjes minimale të ricikluar, do të lejohet të shfaqë tekst shtesë, krahas ekoetiketës, duke komunikuar një udhëzim në lidhje me përmbajtjen. Udhëzimi është dhënë në kriterin 28.

6.a) Standardi i prodhimit 1: Përmbajtje minimale e ricikluar

Fibrat do të prodhohen duke përdorur një përmbajtje minimale prej 20% najlon, i cili është i ricikluar nga mbetje para dhe/ose pas konsumimit.

Vlerësimi dhe verifikimi: përmbajtja e ricikluar do të jetë e gjurmueshme në ripërpunimin e lëndës së parë. Kjo do të verifikohet nga certifikimi i pavarur i zinxhirit të kujdestarisë ose nga dokumentacioni i ofruar nga furnizuesit dhe përpunuesit.

6.b) Standardi i prodhimit 2: emetimet N₂O nga prodhimi monomer

Emetimet në ajër të N₂O nga prodhimi monomer i najlonit, të shprehur si një mesatare vjetore, nuk do të tejkalojnë 9,0 g N₂O/kg të caprolactam (për najlon 6) ose acid adipik (për najlon 6,6).

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë dokumentacion ose raporte testimi duke treguar përputhshmëri bazuar në të dhënat e monitorimit, së bashku me një deklaratë përputhshmërie nga prodhuesi (prodhuesit) e fibrave dhe furnizuesit e tyre të lëndës së parë.

Kriteri 7. Poliestër

Produktet tekstile që janë kryesisht për shitje te konsumatori do të jenë në përputhshmëri me nënkriteret (a) dhe (b). Produktet tekstile, që janë kryesisht për shitje për konsumatorët e sektorit tregtar ose publik, do të përputhen me (a) ose (b) ose (c).

Çdo produkt që përmbush prapën minimal të përmbajtjes së ricikluar, do të lejohet të shfaqë tekst shtesë, krahas ekoetiketës, duke komunikuar një udhëzim në lidhje me përmbajtjen. Udhëzimi është dhënë në kriterin 28.

7.a) Niveli i antimonit, i pranishëm në fibrat e poliestrës, nuk do të tejkalojë 260 ppm. Fibrat e poliestrës, të prodhuara nga shishet PET të ricikluara, janë përjashtuar nga kjo kërkesë.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti ose do të ofrojë një deklaratë për mospërdorim ose një raport testimi duke përdorur metodat e mëposhtme të testimit: përcaktim i drejtpërdrejtë nga Spektrometria me Absorbim Atomik ose Spektrometria Masës me Plazma Induktive të Shoqëruar (ICP). Testimi do të kryhet në një mostër të përbërë të fibrave të papërpunuara, përpara çdo përpunimi të lagësht. Do të ofrohet një deklaratë për fibrat e prodhuara nga shishet PET të ricikluara.

7.b) Fibrat do të prodhohen duke përdorur një përmbajtje minimale të PET, që është ricikluar nga mbetje parakonsumi dhe/ose paskonsumit. Fibrat sintetike do të përmbajnë një përmbajtje minimale prej 50% dhe fibrat filamente (fije e hollë) 20%. Mikrofibrat janë përjashtuar nga kjo kërkesë dhe në vend të kësaj do të përputhen me (c).

Vlerësimi dhe verifikimi: përmbajtja e ricikluar do të jetë e gjurmueshme në ripërpunimin e lëndës së parë. Kjo do të verifikohet nga certifikimi i pavarur i zinxhirit të kujdestarisë ose nga dokumentacioni i ofruar nga furnizuesit dhe përpunuesit.

7.c) Emetimet e VOC gjatë prodhimit të poliestrës, e shprehur si një mesatare vjetore, duke përfshirë edhe emetimet në burime edhe ato që arratisen, nuk do të tejkalojnë 1,2 g/kg për cifat PET dhe 10,3 g/kg për fibrat filamente.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë të dhëna monitorimi dhe/ose raporte testimesh që vërtetojnë përputhshmëri me EN 12619 ose standarde me një metodë testimi ekuivalente. Mesataret mujore për emetimet totale të komponimeve organike nga vendndodhjet e prodhimit për produktet e

ekoetiketuara, do të ofrohen për një minimum prej gjashtë muajsh që i paraprijnë aplikimit.

Kriteri 8. Polipropileni

Pigmentet me bazë plumbi nuk do të përdoren.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një deklaratë për mospërdorim.

Kriteri 9. Fibrat celuloze të bëra nga njerëzit (duke përfshirë viskoze, modale dhe lyocell)

Nënkriteri i prodhimit të pulpit (brumit)

9.a) Një minimum prej 25% të brumit të fibrave do të prodhohen nga druri që është rritur në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm pyjor sipas përkufizimit të UN FAO. Pjesa e mbetur e fibrave të brumit do të jetë brumë që e ka burimin nga pyje dhe plantacione të ligjshme.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të sigurojë nga prodhuesi (prodhuesit) e fibrave, certifikatat e kujdestarisë të zinxhirit të certifikuar, të pavarura dhe të vlefshme, duke vërtetuar që fibrat e drurit janë rritur në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe/ose burimet ligjore. FSC, PEFC ose skemat ekuivalente do të pranohen si certifikime të pavarura.

Prodhuesi i fibrave do të vërtetojë që proceset e verifikimit të duhur janë ndjekur sipas specifikimit në legjislacionin kombëtar në fuqi, në mënyrë që të sigurojnë që druri është vjelë ligjërisht.

9.b) Prodhimi i brumit nga cotton linters/flokë pambuku, si minimum, do të përmbushë kërkesat ose të kriterit të pambukut 1(a) ose 1(b).

Vlerësimi dhe verifikimi: siç tregohet në kriterin korespondues.

9.c) Brumi i përdorur për të prodhuar fibra do të zbardhet/çngjyrosset pa përdorur klorur elemental. Sasia totale rezultuese e klorurit dhe klorurit të lidhur organikisht në fibrat e përfunduara (OX) nuk do të tejkalojë 150 ppm ose në ujëra të ndotura nga prodhimi i brumit (AOX) nuk do të tejkalojë 0,170 kg/ADt brumë.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një raport testimi që tregon përputhshmëri ose me kërkesën OX ose AOX, duke përdorur metodën e duhur të testimit: OX: ISO 11480 (djegje e kontrolluar dhe microcoulometry).

AOX: ISO 9562

9.d) Një minimum prej 50% e brumit të përdorur për të prodhuar fibrat do të blihet nga mullinjët që shkrijnë brumin, që rekuerojnë vlerë nga likernat e proceseve të harxhuara të tyre ose duke:

i) Prodhuar energji dhe avull në vendndodhje

ii) Prodhuar bashkëproduktet kimike

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një listë të furnizuesve të brumit, që furnizojnë lëndën e parë, që përdoret për të bërë fibrat dhe përqindjen e brumit që ato furnizojnë. Do të ofrohet dokumentacion dhe evidencë që përqindja e kërkuar e furnizuesve, të ketë pajisjet e duhura të prodhimit të energjisë dhe/ose sistemet e rikuperimit të bashkëprodhimit dhe prodhimit, të instaluar në vendndodhjet përkatëse.

Nënkriteri i prodhimit të fibrave

9.e) Për fibrat vizkoze dhe modale, përmbajtja e sulfurit, të emetimeve të komponimeve të sulfurit në ajër, nga proceset e prodhimit të fibrave, të shprehura si një mesatare vjetore, nuk do të tejkalojnë vlerat e mëposhtme të performancës në tabelën 4.

Tabela 4

Vlerat e emetimit të sulfurit të fibrave viskoze dhe modale

Lloji i fibrave	Vlera e performancës (g S/kg)
Fibra kryesore/bazë	30 g/kg
Fibra filamente	
- larja në grumbull/grup	40 g/kg
- larja e integruar	170 g/kg

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë dokumentacion të detajuar dhe/ose raporte testimi që tregojnë përputhshmëri me këtë kriter, së bashku me një deklaratë përputhshmërie.

2. KRITERET E KOMPONENTËVE DHE AKSESORËVE

Kriteret në këtë seksion zbatohen për komponentët dhe aksesorët që formojnë pjesë të një produkti

përfundimtar.

Kriteri 10. Mbushjet

10.a) Materialet e mbushjes, që konsistojnë në fibra tekstile, do të përputhen me kriterin e fibrave tekstile (1-9) kur është e përshtatshme.

10.b) Materialet e mbushjes do të përputhen me kërkesat tekstile RSL për biocidet dhe formaldehidet (shih shtojcën 1).

10.c) Detergjentet dhe kimikate të tjera, të përdorura për larjen e mbushjeve (poshtë/nën, pupla, fibra natyrale ose sintetike) do të përputhen me kërkesat tekstile RSL për kimikatet ndihmëse dhe për detergjentët, zbutësit dhe agjentët kompleksues (shih shtojcën 1).

Kriteri 11. Veshjet, laminatet dhe membranat

11.a) Komponentët e përbërë nga poliuretani do të përputhen me kriterin e fibrave tekstile 5 (a) në lidhje me kallaj organik dhe 5(b) në lidhje me ekspozimin në vendin e punës ndaj diizocianate aromatike dhe DMA.

11.b) Komponentët e përbërë nga poliestra do të përputhen me kriterin e fibrave tekstile 7 (a) dhe 7 (c) në lidhje me përmbajtjen e anitmonit dhe emetimin e VOC gjatë polimerizimit.

11.c) Polimerët do të përputhen me kufizimin g(v) të listës së substancave të ndaluara në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

Vlerësimi dhe verifikimi: siç tregohet në kriteret koresponduese dhe/ose në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

Kriteri 12. Aksesorët

Komponentët metalikë dhe plastikë, të tillë si: zinxhirët, kopsat dhe kapëset/togëzat do të përputhen me kërkesat RSL për aksesorët (shih shtojcën 1).

Vlerësimi dhe verifikimi: siç tregohet në kriterin korrespondues.

3. KRITERET E KIMIKATEVE DHE TË PROCESIT

Kriteret në këtë seksion zbatohen, kur specifikohet, për fazat e mëposhtme të prodhimit:

- i) tjerja;
- ii) formimi i pëlhurës;
- iii) paratrajtimi;
- iv) lyerja/ngjyrosja;
- v) stampimi;
- vi) përfundimi;
- vii) prerja/bërja/përshtatja.

Me përjashtim nëse specifikohet ndryshe, duke përfshirë kërkesat për testim të rastësishëm, do të zbatohen, gjithashtu, për fibrat që përmbajnë përmbajtje të ricikluar.

Kriteri 13. Lista e substancave të kufizuara (RSL)

13.a) Kërkesa të përgjithshme

Produkti përfundimtar dhe recetat e prodhimit, të përdorura për të prodhuar produktin përfundimtar, nuk do të përmbajnë substanca të rrezikshme të renditura në listën e substancave të kufizuara në ose mbi limitet e specifikuar të përqendrimit ose në përputhje me kufizimet e specifikuar. RSL-ja mund të gjendet në shtojcën 1. Kufizimet në listën e substancave të ndaluara kanë përparësi mbi përjashtimet e renditura në kriterin 14, tabela 6.

RSL-ja do t'u komunikohet furnizuesve dhe agjentëve përgjegjës për fazat e tjerjes, ngjyrosjes, stampimit dhe përfundimit. Kërkesat e verifikimit dhe testimit janë specifikuar në listë për çdo fazë prodhimi dhe për produktin përfundimtar.

Testimi laboratorik, kur kërkohet, do të kryhet për çdo linjë produkti bazuar në marrje motrash të rastësishme. Testimi do të kryhet çdo vit, gjatë periudhës së licencës, në mënyrë që të vërtetohet përputhshmërinë në vazhdim me RSL-në.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një deklaratë përputhshmërie me RSL-në të mbështetur nga evidenca, siç janë të zbatueshme për substancat dhe recetat e prodhimit të përdorura për të prodhuar produktin përfundimtar. Kërkesat tregohen në RSL dhe përfshijnë deklaratat e siguruar nga ato përgjegjës për fazat përkatëse të prodhimit, deklaratat nga furnizuesit e kimikateve dhe rezultatet e testimit nga analizimi laboratorik i mostrave të produktit përfundimtar. Të dhënat e testimit, të siguruar për qëllimet e përputhshmërisë, me industrinë RSL dhe skema të tjera, do të pranohen kur metodat e testimit janë ekuivalente dhe janë kryer mbi një mostër përfaqësuese të produktit përfundimtar.

Dështimi i një rezultati testimi, gjatë periudhës së licencës, do të rezultojë në ritestim për linjën

specifike të produktit. Nëse testi i dytë dështon më pas licenca do të pezullohet për linjën specifike të produktit. Më pas do të kërkohen masa përmirësuese, në mënyrë që të rivendoset (rikthehet) licenca.

13.b) Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC)

Produkti përfundimtar, duke përfshirë çdo komponent ose aksesor, me përjashtim nëse është përjashtuar specifikisht, nuk do të përmbajë substanca që përjashtohen nga legjislacioni në fuqi në fushën e kimikateve.

Aplikimi i të tilla kriterëve do të bëhet sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi në fushën në fjalë.

Substancat dhe recepturat që përdoren gjatë gjithë staveve të prodhimit të produktit do t'i nënshtrohen vlerësimit të hollësishëm në përputhje me listën kandidatë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi në fushën e kimikateve. Aplikanti përgatit deklaratën e përputhshmërisë për çdo fazë të prodhimit, bazuar në dokumentacionin e vlerësimit.

Kjo zbatohet për substancat e përdorura për të dhënë funksionin e produktit përfundimtar dhe për substanca që janë përdorur qëllimisht në formulat e prodhimit.

Nuk do të jepet asnjë përjashtim, në lidhje me substancat që përmbushin ose këto dy kushte dhe të cilat janë të pranishme në një artikull tekstil ose në çdo pjesë homogjene të një artikulli tekstil kompleks, në përqendrim më të lartë se 0,10% (peshë për peshë).

Vlerësimi dhe verifikimi: substancat dhe recepturat të përdorura për çdo fazë prodhimi do t'i nënshtrohen vlerësimit të hollësishëm në përputhje me listën kandidatë të publikuar nga autoriteti kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e kimikateve. Aplikanti përgatit deklaratën e përputhshmërisë për çdo fazë të prodhimit, bazuar në dokumentacionin e vlerësimit.

Kur është dhënë një përjashtim atëherë aplikanti do të tregojë që përdorimi i substancës është në përputhshmëri me kufijtë e përqendrimit dhe kushtet e përjashtimit të përcaktuara në RSL.

Kriteri 14. Zëvendësimi i substancave të rrezikshme të përdorura në ngjyrosje, stampim dhe përfundim

Substancat e zbatuara për pëllhurat dhe panelet e thurura (punuar me shtiza) gjatë proceseve të ngjyrosjes, stampimit dhe përfundimit, të cilat mbeten në produktin përfundimtar dhe në përputhje me legjislacionin specifik në fuqi që mbulon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, përmbushin kriteret për klasifikim me klasat e rrezikshme ose frazat e riskut të renditura në tabelën 5, nuk do të përdoren me përjashtim nëse janë përjashtuar specifikisht. Këto kufizime do të zbatohen, gjithashtu, për substancat funksionale të inkuorporuara në fibrat e bëra nga njerëzit gjatë prodhimit të tyre.

14.a) Kufizimet e klasifikimit të rrezikut

Kufizimet e klasifikimeve të rrezikut janë renditur në tabelën 5. Rregullat më të fundit të klasifikimit të miratuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi do të kenë përparësi mbi klasifikimet e renditura të rrezikut dhe frazave të riskut. Si rrjedhojë, aplikantët do të sigurojnë që çdo klasifikim është bazuar në rregullat më të fundit të klasifikimit.

Përdorimi i substancave ose përzierjeve, të cilat ndryshojnë veçoritë e tyre gjatë përpunimit (p.sh., nuk janë më të disponueshme biologjikisht, pësojnë modifikime kimike) në mënyrë që rreziku i identifikuar nuk zbatohet më, përjashtohen nga kërkesat e mësipërme. Kjo do të përfshijë polimerët që janë modifikuar për të inkuorporuar një funksion dhe monomerët ose aditivët të cilët lidhen në mënyrë kovalente me polimerët.

Tabela 5

Klasifikimi i rrezikut dhe frazat e riskut të kufizuara dhe kategorizimi i tyre CLP

Toksicitet akute	
Kategoritë 1 dhe 2	Kategoria 3
H300 Fatale nëse gëlltitet (R28)	H301 Toksike nëse gëlltitet (R 25)
H310 Fatale nëse bie në kontakt me lëkurën (R27)	H311 Toksike nëse bie në kontakt me lëkurën (R24)
H330 Fatale nëse thithet (R 26/26)	H331 Toksike nëse thithet (R 23)

H304 Mund të jetë fatale nëse gëlltëhet dhe hyn në rrugët e frymëmarrjes (R 65)	EUH070 Toksike nëse bie në kontakt me sytë (R 39/41)
---	--

Toksiciteti specifik me objektiv një organ

Kategoria 1	Kategoria 2
H370 Shkakton dëmtim të organeve (R39/23, R39/24, R39/25, R39/26, R39/27, R39/28)	H371 Mund të shkaktojë dëmtim të organeve (R68/20, R68/21, R68/22)
H372 Shkakton dëmtim të organeve nëpërmjet ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur (R48/25, R48/24, R48/23)	H373 Mund të shkaktojë dëmtim të organeve nëpërmjet ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur (R48/20, R48/21, R48/22)

Ndjeshmëria e frymëmarrjes dhe lëkurës

Kategoria 1A	Kategoria 1B
H317: Mund të shkaktojë reagim alergjik të lëkurës (R 43)	H317: Mund të shkaktojë reagim alergjik të lëkurës (R 43)
H 334 Mund të shkaktojë simptoma alergjie ose astme ose vështirësi në frymëmarrje nëse thithet (R 42)	H 334 Mund të shkaktojë simptoma alergjie ose astme ose vështirësi në frymëmarrje nëse thithet (R 42)

Kancerogjene, mutagjene ose toksike për riprodhim

Kategoria 1A dhe 1B	Kategoria 2
H340 Mund të shkaktojë defekte gjenetike (R 46)	H341 Dyshohet që shkakton defekte gjenetike (R68)
H350 Mund të shkaktojë kancer (R45)	H351 Dyshohet që shkakton kancer (R40)
H350i Mund të shkaktojë kancer nga thithja (R 49)	
H360F Mund të dëmtojë fertilitetin (R60)	H361f Dyshohet që dëmton fertilitetin (R62)
H360D Mund të dëmtojë foshnja të palindura (R61)	H361d Dyshohet që dëmton foshnja të palindura (R63)
H360FD Mund të dëmtojë fertilitetin. Mund të dëmtojë foshnja të palindura (R60, R60/61)	H361fd Dyshohet që dëmton fertilitetin. Dyshohet që dëmton foshnja të palindura (R62/63)

Toksike akute

Kategoritë 1 dhe 2	Kategoria 3
H360Fd Mund të dëmtojë fertilitetin. Dyshohet që dëmton foshnja të palindura (R60/63)	H362 Mund të shkaktojë dëm për fëmijët që ushqehen me gji (R 64)
(R60/63) Mund të dëmtojë foshnja të palindura. Dyshohet që dëmton fertilitetin. (R61/62)	

Të rrezikshme për mjedisin ujor

Kategoritë 1 dhe 2	Kategoritë 3 dhe 4
H 400 Shumë toksike për jetën ujore (R50)	H412 Të dëmshme për jetën ujore me efekte që zgjasin për një kohë të gjatë (R52/53)
H 410 Shumë toksike për jetën ujore me efekte që zgjasin për një kohë të gjatë (R50/53)	H413 Mund të shkaktojë efekte që zgjasin për një kohë të gjatë ndaj jetës ujore (R53)
H 411 Toksike për jetën ujore me efekte që zgjasin për një kohë të gjatë (R51/53)	

Të rrezikshme për shtresën e ozonit

EUH059 Të rrezikshme për shtresën e ozonit (R59)	
--	--

14. Përrjashtimet do të zbatohen për grupet e substancave tekstile

Në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën përkatëse, grupet e substancave në tabelën 6 janë përjashtuar specifikisht nga kërkesat e përcaktuara në kriterin 14(a) dhe në përputhje me kushtet e përjashtimit të përshkruar në tabelën 6. Për çdo grup substance, të gjitha kushtet e përjashtimit janë parashikuar për klasifikimet e specifikuar të rrezikut. Këto përjashtime do të zbatohen për substancat e shtuara në fibrat sintetike të bëra nga njerëzit dhe fibrat celuloze gjatë prodhimit të tyre.

Tabela 6
Përrjashtimet sipas grupit të substancave të klasifikimit të rrezikut

Substancat që i japin funksion produktit përrfundimtar		
Grupi i substancës	Klasifikimet e rrezikut të përjashtuara	Kushtet e përjashtimit
i) Lëndë ngjyruese për ngjyrosjen e stampimit pa -pigment	H301, H311, H331, H317, H334	Formulime ngjyrosje pa pluhur ose dozim automatik dhe shpërndaja e ngjyrave do të përdoret nga fabrikat dhe printerat e ngjyrosjes për të minimizuar ekspozimin e punonjësve.
	H411, H412, H413	Proceset e ngjyrosjes, duke përdorur ngjyra/bojëra reaktive, të drejtpërdrejta, të patretshme në ujë, sulfuri, me këto klasifikime, do të përmbushin një minimum të një nga kushteve të mëposhtme: - Përdorimi i ngjyrave me afinitet/tërheqje të lartë; - Arritja e një përqindjeje refuzimi prej më pak se 3,0%; -Përdorimi i instrumentimit të përputhjes së ngjyrave; - Implementimi i procedurave standarde të operimit përprocesin e ngjyrosjes; - Përdorimi heqjes së ngjyrës, për të trajtuar ujërat e ndotura, në përputhje me kriterin 16(a); Përdorimi i ngjyrave tretësirë (solucion) dhe/ose stampimit dixhital janë përjashtuar nga këto kushte.
ii) Ngadalësuesit e flakës	H317 (1B), H373, H411, H412, H413	- Produkti duhet të synohet që të përdoret në aplikime, në të cilat kërkohet përmbushja e kërkesave të mbrojtjes nga zjarri,në standardet dhe rregulloret e prokurimeve në ISO, EN ose sektorin publik. - Produkti do të përmbushë kërkesat për qëndrueshmëri të funksionit (shih kriterin 25).

Substancat që i japin funksion produktit përfundimtar

Grupi i substancës	Klasifikimet e rrezikut të përjashtuara	Kushtet e përjashtimit
	H351 është përjashtuar për zbatimin e synergist antimon trioksid si një veshje e pjesës së mbrapme për tekstilet e brendshme	- Produkti duhet të synohet që të përdoret në aplikime në të cilat kërkohet përmbushja e kërkesave të mbrojtjes nga zjarri në standardet dhe rregulloret e prokurimeve në ISO, EN, shtetet anëtare ose sektorin publik. - Emetimet në ajër në vendin e punës, ku zbatohet ngadalësuesi i flakës te produktet tekstile, do të përmbushë një vlerë kufi për tetë orë ekspozim profesional, prej 0,50 mg/m ³ .
iii) Ndriçuesit (zbardhuesit) optikë	H411, H412, H413	Ndriçuesit optikë mund të zbatohen vetëm në rastet e mëposhtme: - Në stampime me ngjyrë të bardhë; - Për të arritur ndriçim të përmirësuar në uniforma dhe veshjet e punës; - Si aditivë gjatë prodhimit të poliamidit dhe poliestrës me një përmbajtje të ricikluar.
iv) Substancë e papërshkueshme nga (repellents) uji, papastërtia dhe njollat	H413	- Repellent dhe produktet e tij të përjashtimit do të jenë lehtësishtandor, në mënyrë të natyrshme të biodegradueshme dhe jobioakumulative në mjedisin ujor, duke përfshirë sedimentet ujore. - Produkti do të përmbushë kërkesat për qëndrueshmëri të funksionit (shih kriterin 25).

Substanca të tjera mbetjesh që mund të gjenden në produktin përfundimtar

v) Ndihmëse duke përfshirë: Transportuesit, Agjentët e nivelimit, Agjentët e shpërndarjes, Surfaktantët, Produkte të përdorura për trashësi, Lidhës	H301, H311, H331, H371, H373, H317 (1B), H334, H411, H412, H413, EUH070,	Recetat do të formulohen duke përdorur sistemet e dozimit automatik dhe proceset do të ndjekin procedura standarde operimi. Substancat e klasifikuara me H311, H331, H317 (1B) nuk do të jenë të pranishme në produktin përfundimtar në përqendrime më të mëdha se 1,0 % w/w.
---	--	--

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të sigurojë deklaratat e përputhshmërisë nga çdo vendndodhje prodhimi për ngjyrosje, stampim dhe përfundim dhe, kur është e nevojshme, furnizuesit e tyre të kimikateve. Kjo do të deklarojë që, kur përdoren në receta prodhimi, substancat e mëposhtme, sëbashku me çdo substancë funksionale shtesë të përdorur, që mund të mbeten në produktin përfundimtar, nuk përmbushin kriteret për klasifikimin me një ose më shumë nga klasifikimet e rrezikut dhe frazat e riskut të renditura në tabelën 5:

- biocidet;
- materialet ngjyrosëse dhe pigmentet;
- transportues, agjentë nivelin dhe agjentë shpërndarës shtesë;
- ndriçues optikë;
- materiale trashësie, lidhës dhe plastifikues të stampimit;
- agjentët e lidhjeve të tërthorta (nga finitura me mirëmbajtje të lehtë dhe stampimi);
- ngadalësuesit e flakës dhe synergist;
- repellents në ujë, pisllek dhe njolla;
- zbutës pëlhurash.

Kur substancat janë përjashtuar në tabelën 6, atëherë deklarata do të identifikojë specifikisht ato substanca të përjashtuara dhe do të ofrojë evidenca mbështetëse që tregojnë se si janë përmbushur

kushtet e përjashtimit.

Përjashtimi (v). Ndihmëset do të kërkojë verifikim bazuar në testimet e laboratorit të prodhimit përfundimtar nëse formulat e prodhimit përfshijnë substanca që mbajnë klasifikimet e specifikuar të rrezikut.

Informacioni i mëposhtëm teknik do të ofrohet për të mbështetur deklaratën e klasifikimit ose joklasifikimit për çdo substancë:

i) për substancat që nuk janë regjistruar sipas legjislacionit kombëtar në fuqi në fushën e kimikateve ose që nuk kanë një klasifikim CLP të harmonizuar;

ii) për substancat që janë regjistruar sipas legjislacionit kombëtar në fuqi që konfirmon statusin e paklasifikuar të substancës, të cilat nuk plotësojnë kriteret e klasifikimit CLP;

iii) për substanca që kanë një klasifikim të harmonizuar ose janë të vetëklasifikuara. Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë teknike kur është e mundur. Nëse këto nuk janë të vlefshme ose substanca është e vetëklasifikuar, atëherë do të jepet informacioni përkatës mbi klasifikimin e rrezikut të substancave në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi në fushën e kimikateve;

iv) në rastin e përzierjeve: dokumentacioni me të dhënat e sigurisë kur është i disponueshëm. Nëse ky nuk është i disponueshëm atëherë llogaritja e klasifikimit të përzierjes do të sigurohet në përputhje me rregullat e legjislacionit përkatës që mbulon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, së bashku me informacionin përkatës mbi klasifikimin e rrezikut të përzierjeve në përputhje me kërkesat specifike të ligjit për menaxhimin e kimikateve në fuqi.

Kriteri 15. Efikasiteti i energjisë gjatë larjes, tharjes dhe përkujdesjes (mirë-mbajtjes)

Aplikanti do të vërtetojë që energjia e përdorur në hapat e larjes, tharjes dhe mirëmbajtjes, të shoqëruar me hapat e ngjyrosjes, stampimit dhe përfundimit për produktet e ekoetiketuara, matet dhe ka parametra reference/krahasimi (*Benchmarkes*) si pjesë e një sistemi menaxhimi të emetimeve të dyoksidit të karbonit ose energjisë.

Për më tepër, ato do të vërtetojnë që vendndodhjet e prodhimit kanë implementuar një numër minimal të teknikave më të mira të disponueshme (TMD) të teknikave të efikasitetit të energjisë, siç është specifikuar në tabelën 7 dhe siç është renditur në shtojcën e këtij udhëzimi.

Tabela 7

Teknikat e efikasitetit të energjisë për larje, shpëlarje dhe tharje

Temat TMD	Volumi i prodhimit	
	< 10 tonë/ditë	> 10 tonë/ditë
1. Menaxhimi i përgjithshëm i energjisë	Dy teknika	Tri teknika
2. Proceset e larjes dhe shpëlarjes	Një teknikë	Dy teknika
3. Tharja dhe përkujdesja duke përdorur korniza për tendosje/hapje	Një teknikë	Dy teknika

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të hartojë raportimin nga sistemet e menaxhimit të energjisë, për çdo vendndodhje prodhimi, për ngjyrosje, stampim dhe përfundim. ISO 50001 ose sisteme ekuivalente për emetimet e energjisë ose të dyoksidit të karbonit, do të pranohen si evidencë për sistemin e menaxhimit të energjisë.

Evidenca e kërkuar për implementimin e TMD-vë, si minimum, do të përfshijë fotografi të vendndodhjes, përshkrimet e teknikave, të çdo teknike dhe vlerësimet e kursimeve të arritura të energjisë.

Kriteri 16. Trajtimi i emetimeve në ajër dhe ujë

16.a) Shkarkimet e ujërave të ndotura nga përpunimi/trajtimi i lagësht

Shkarkimet e ujërave të ndotura në mjedis nuk do të tejkalojnë 20g COD/kg të tekstileve të përpunuara. Kjo kërkesë do të zbatohet për proceset e gërshetimit/thurjes, ngjyrosjes, stampimit dhe përfundimit/finiturës, të përdorura për të prodhuar produktin (produktet). Kërkesat do të maten në rrjedhën e poshtme, të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, në vendndodhje dhe/ose impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura përtej vendndodhjes që marrin ujëra të ndotura nga këto vendndodhje

përpunimi.

Nëse rrjedhjet/prurjet trajtohen në vendndodhje dhe shkarkohen drejtpërdrejt në ujërat sipërfaqësore, do të përmbushë, gjithashtu, kërkesat e mëposhtme:

i) pH ndërmjet 6,0 dhe 9,0 (me përjashtim nëse pH i ujërave marrëse është jashtë këtij diapazoni);

ii) temperatura më pak se 35°C (me përjashtim nëse temperatura e ujërave marrëse është mbi këtë vlerë).

Nëse kërkohet heqja e ngjyrës, nga një kusht përjashtimi në kriterin 14, atëherë do të përmbushen koeficientët e mëposhtëm të përthithjes (absorbim) spektrale:

i) 436 nm (sektori i verdhë) 7 m-1;

ii) 525 nm (sektori i kuq) 5 m-1;

iii) 620 nm (sektori blu) 3 m-1.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë dokumentacion të detajuar dhe raporte testimi, duke përdorur ISO 6060 dhe ISO 7887, si të jetë përkatëse dhe duke treguar përputhshmëri me këtë kriter, në bazë të mesatareve mujore për gjashtë muaj që i paraprijnë aplikimit, së bashku me një deklaratë përputhshmërie. Të dhënat do të vërtetojnë përputhshmëri nga vendndodhja e prodhimit ose, nëse rrjedhjet trajtohen përtej vendndodhjes, nga një operator i trajtimit të ujërave të ndotura.

16.b) Emetimet në ajër nga proceset e stampimit dhe përfundimit/finiturat

Emetimet totale të komponimeve organike, siç janë përcaktuar në legjislacionin në fuqi, nga vendndodhjet e prodhimit të printimit dhe përfundimit të tekstileve të përdorura për të prodhuar produktin (produktet) e ekoetiketuara nuk do të tejkalojnë 100,0 mg C/Nm³.

Kur proceset e veshjeve dhe tharjeve të tekstileve lejojnë për rikuperimin dhe ri përdorimin e tretësve, do të zbatohet një kufi emetimit prej 150,0 mg C/Nm³.

Proceset e përfundimit/finiturat përfshijnë *thermosetting*, *thermosoling*, veshjen dhe mbushjen e tekstileve duke përfshirë strukturat e tyre përkatëse të tharjes (tenda për tendosje, hapje).

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të vërtetojë përputhshmëri në përputhje me EN 12619 ose standarde të tjera kombëtare ekuivalente. Mesataret mujore për emetimet totale të komponimeve organike nga vendndodhjet e prodhimit do të sigurohen për gjashtë muajt që i paraprijnë aplikimit. Kur kryhet rikuperimi dhe ripërdorimi i tretësve atëherë të dhënat e monitorimit do të ofrohen si evidencë të operimit të këtyre sistemeve.

4. PËRSHTATSHMËRIA PËR PËRDORIM

Kriteret në këtë seksion zbatohen për pëlhura të ndërmjetme dhe produkte të thurura (punuar me shtizë) dhe për produktin përfundimtar.

Kriteri 17. Ndryshimet dimensionale gjatë larjes dhe tharjes

Ndryshimet dimensionale pas larjes dhe tharjes ose në temperaturë larje shtëpiake ose industriale dhe kushtet nuk do të tejkalojnë ato të specifikuara në tabelën 8.

Tabela 8

Tolerancat për ndryshimet dimensionale gjatë larjes dhe tharjes

Produktet tekstile ose lloji i materialit	Ndryshimet dimensionale gjatë larjes dhe tharjes
Pëlhura të thurura	± 4,0 %
Pëlhurë e fortë (<i>chunky</i>)	± 6,0 %
Bashkim	± 5,0 %
Pëlhura të endura:	± 3,0 %
- pambuk dhe përzierje pambuku;	± 2,0 %
- përzierje leshi;	± 2,0 %
- fibra sintetike.	
Çorapë dhe artikuj të trikotuar	± 8,0 %
Veshje për banjë, duke përfshirë artikuj sfungjeri dhe pëlhura të rafinuararib(brinje).	± 8,0 %
Tapiceri e endur që mund të lahet dhe mund të hiqet – perde dhe pëlhura mobiliesh.	± 2,0 %
- Pëlhurë dyshekësh	± 3,0 %

Pëlhura jo të endura	
- Pëlhurë dyshekësh;	± 5,0 %
- Pëlhura të tjera.	± 6,0 %

Ky kriter nuk zbatohet për:

- fibra ose fije;
- produkte të etiketuara qartë “vetëm për pastrim kimik” ose ekuivalente;
- pëlhura mobilie që nuk mund të hiqen apo të lahen.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte testesh duke përdorur standarde të përshtatshme për produktin.

Për larje shtëpiake EN ISO 6330 në kombinim me EN ISO 5077 do të përdoren si më poshtë: tri larje në temperatura siç tregohet në produkt, me tharje tumble pas çdo cikli larje.

Për larje komerciale në lavanderitë industriale ISO 15797 në kombinim me EN ISO 5077 do të përdoret në një minimum prej 75°C ose siç tregohet në standardin për kombinimin e fibrave dhe zbardhuesve. Tharja do të bëhet siç është treguar në etiketën e produktit.

Në mënyrë alternative për pëlhura dysheku, që mund të hiqen ose mund të lahen, do të përdoren EN ISO 6330 në kombinim me EN 25077. Kushtet e përcaktuara do të jenë larje 3A (60°C) dhe tharje C (tharje e sheshtë) për përjashtim nëse etiketa e produktit deklaron ndryshe.

Kriteri 18. Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj larjes

Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj larjes do të jetë të paktën niveli 3-4 për ndryshim ngjyre dhe të paktën niveli 3-4 për çngjyrosje.

Ky kriter nuk zbatohet për produktet e etiketuara “vetëm për pastrim kimik” ose ekuivalente (deri më tani, pasi është praktikë normale për produkte të tilla të jenë të etiketuara në këtë mënyrë), për produkte të bardha ose produkte të cilat as nuk janë ngjyrosur dhe as stampuar ose për pëlhura mobilie, të cilat nuk mund të lahen.

Vlerësimi dhe verifikimi: për larje shtëpiake aplikanti do të ofrojë raportet e testimit, duke përdorur metodën e testimit: ISO 105 C06 (larje e vetme, në temperaturë të shënuar mbi produkt, me pluhur perborat).

Për larje tregtare/komerciale në lavanderitë industriale do të përdoret ISO 15797 në kombinim me ISO 105 C në një minimum prej 75°C ose siç tregohet në standardin për kombinimin e fibrave dhe zbardhuesit.

Kriteri 19. Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj djersitjes/perpirimit (acid, alkaline)

Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj djersitjes (acid, alkaline) do të jetë të paktën niveli 3-4 (ndryshimi i ngjyrës dhe çngjyrosja). Megjithatë një nivel prej 3 është lejuar kur pëlhurat janë edhe me ngjyrë të errët (thellësia standarde >1/1) dhe të bërë nga lesh i rigjeneruar. Ky kriter nuk zbatohet për produktet e bardha, për produkte të cilat as nuk janë ngjyrosur dhe as stampuar ose për pëlhura mobilie, perde ose tekstile të ngjashme të destinuara për dekorim të brendshëm.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte testimesh duke përdorur metodën e mëposhtme të testimit: ISO 105 E04 (acid dhe alkaline, krahasim me pëlhura me fibra të shumëfishta/multifibre)

Kriteri 20. Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj fërkimit të lagësht

Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj fërkimit të lagësht do të jetë të paktën niveli 2–3. Megjithatë një nivel 2 lejohet për xhinse të ngjyrosura lejla.

Ky kriter nuk zbatohet për produktet e bardha ose produkte të cilat as nuk janë ngjyrosur dhe as stampuar.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte testimesh duke përdorur metodën e mëposhtme të testimit: ISO 105 X12.

Kriteri 21. Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj fërkimit të thatë

Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj fërkimit të thatë do të jetë të paktën niveli 4. Megjithatë një nivel 3-4 lejohet për xhinse të ngjyrosura lejla.

Ky kriter nuk zbatohet për produktet e bardha ose produkte të cilat as nuk janë ngjyrosur dhe as stampuar ose perde dhe tekstile të ndryshme të destinuara për dekorim të brendshëm.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte testimesh duke përdorur metodën e mëposhtme të testimit: ISO 105 X12.

Kriteri 22. Qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj dritës

Për pëlhura të synuara për mobilie, perde ose perde të gjata/mbulesa, qëndrueshmëria/fortësia e ngjyrës ndaj dritës do të jetë të paktën niveli 5. Për të gjitha produktet e tjera qëndrueshmëria /fortësia e ngjyrës ndaj dritës do të jetë të paktën niveli 4.

Megjithatë lejohet një nivel 4, kur pëlhurat që synohen për mobilie, perde ose perde të gjata/mbulesa janë edhe me ngjyrë të hapur (thellësia standarde $<1/12$) dhe janë bërë me më shumë se 20% lesh ose fibra të tjera keratine ose fibra të tjera prej lëvoreje bliri.

Kjo kërkesë nuk zbatohet për pëlhura dyshekësh, mbrojtëse dysheku ose veshje të brendshme.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte testimesh duke përdorur metodën e mëposhtme të testimit: ISO 105 B02.

Kriteri 23. Rezistente ndaj larjes dhe aftësia e thithjes të produkteve të pastrimit

Produktet e pastrimit do të jenë rezistente ndaj larjes dhe thithëse, në përputhje me parametrat përkatës të testimit të identifikuar në tabelat 9 dhe 10. Testimi i specifikuar për thithje nuk do të zbatohet për produktet me fije të përdredhura.

Tabela 9

Vlerat dhe parametrat për rezistencën ndaj ujit të produkteve të pastrimit

Produkte pastrimi tekstile ose lloji i materialit	Numri i larjeve	Temperatura	EN ISO 6630 referenca e testimit
Produkte të endura dhe jo të endura për pastrimin e lagësht	80	40°C	Procedura 4N
Produkte me mikrofibra për pastrimin e pëlhurave	200	40°C	Procedura 4N
Produkte që vijnë nga fibra tekstile të ricikluara	20	30°C	Procedura 3G
Leckë për larjen e dyshemeve	200	60°C	Procedura 6N
Rroba/veshje për larjen e dyshemeve	5	30°C	Procedura 3G

Tabela 10

Vlerat dhe parametrat për thithjen e produkteve të pastrimit

Produkte pastrimi tekstile ose lloji i materialit	Koha e thithjes së lëngjeve
Produkte që vijnë nga fibra tekstile të ricikluara	≤ 10 sekonda
Produkte me mikrofibra për pastrimin e sipërfaqeve dhe dyshemeve	≤ 10 sekonda
Produkte të endura dhe jo të endura për pastrimin e lagësht	≤ 10 sekonda
Leckë për larjen e dyshemeve	≤ 10 sekonda

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raportet e testeve duke përdorur metodat e mëposhtme të testimit, si të jetë përkatëse: EN ISO 6330 dhe EN ISO 9073-6. Testimi në përputhje me EN ISO 6330 do të kryhet duke përdorur lavatriçe lloji A për të gjitha produktet dhe materialet.

Kriteri 24. Rezistenca e pëlhurave ndaj krijimit të gungave dhe gërryerjes (abrazi-onit)

Pëlhura jo të endura dhe veshje të thurura, aksesorë dhe mbulesa të bëra nga leshi, përzierje leshi dhe poliestër (duke përfshirë lesh bagëtie), do t'i rezistojnë krijimit të gungave në vlerësim prej një minimumi 3.

Pëlhura pambuku të endura, të përdorura për veshje, do t'i rezistojnë krijimit të gungave në një vlerësim prej 3. Getat dhe streçet do t'i rezistojnë një vlerësimi prej një minimumi prej 2.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte nga testimet e kryera si të jenë të përshtatshme me nënshtresën:

- produktet e thurura dhe jo të endura: ISO 12945-1 metoda kutia e pilulës (*Pill Box*);

- Pëlhura të endura: ISO 12945-2 metoda martindale.

Kriteri 25. Qëndrueshmëria/jetëgjatësia e funksionit

Përfundimet/finiturat, trajtimet dhe aditivët që japin ujë, vaj dhe njolla rezistente ndaj ngadalësimit të flakëve dhe kujdesje/mirëmbajtje të lehtë (gjithashtu, referuar si parrudha ose hekurosje e përhershme) për produktin tekstil, kur ai është në përdorim, do të jetë i qëndrueshëm në përputhje me vlerat dhe parametrat e përcaktuar në nënkriterin 25(a), (b) dhe (c).

Për rezistencën/papërshkueshmërinë nga uji, vaji ose njollat, konsumatorët do të pajisen me një udhëzues për mënyrën sesi të ruajnë funksionalitetin e lëmimit/finiturës të aplikuar në produkt.

Fibrat tekstile, pëlhurat dhe membranat që i japin produktit përfundimtar karakteristikat e brendshme janë përjashtuar nga këto kërkesa.

Vlerësimi dhe verifikimi: për produktet me karakteristika të brendshme, aplikantët do të ofrojnë raportet e testime duke vërtetuar performancë të krahasueshme ose të përmirësuar, të krahasuar me alternativat që mund të zbatohen si finitura.

25.a) Funksionet e rezistencës ndaj ujit, vajit dhe njollave

Substancat rezistente ndaj ujit do të mbajnë një funksionalitet prej 80 nga 90, pas 20 larjeve shtëpiake dhe cikleve të tharjes tumble në 40°C, ose pas 10 larjeve industriale dhe cikleve të tharjes në një minimum prej 75°C.

Substancat rezistente ndaj vajit do të mbajnë një funksionalitet prej 3,5 nga 4,0, pas 20 larjeve shtëpiake dhe cikleve të tharjes tumble në 40°C, ose pas 10 larjeve industriale dhe cikleve të tharjes në një minimum prej 75°C.

Substancat rezistente ndaj njollave do të mbajnë një funksionalitet prej 3,0 nga 5,0, pas 20 larjeve shtëpiake dhe cikleve të tharjes tumble në 40°C ose pas 10 larjeve industriale dhe cikleve të tharjes në një minimum prej 75°C.

Temperaturat e larjeve industriale mund të reduktohen në 60°C për veshje me shtresa të qepura (me tegel).

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte nga testimet e kryera në përputhje me standardet e mëposhtme, si të jetë e përshtatshme për produktin:

Për të gjitha ciklet e larjeve shtëpiake të produkteve ISO 6330 ose ciklet e lavanderisë industriale ISO 15797, në kombinim me:

- substancat rezistente ndaj ujit: ISO 4920;
- substancat rezistente ndaj vajit: ISO 14419;
- substancat rezistente ndaj njollave: ISO 22958.

25.b) Funksionet e ngadalësuesit të flakës

Produktet që mund të lahet do të mbajnë funksionalitetin e tyre pas 50 larje industriale dhe cikle tharje tumble në një minimum prej 75°C. Produktet që nuk mund të lahen do të mbajnë funksionalitetin e tyre pas një testi lagie.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte nga testimet e kryera në përputhje me standardet e mëposhtme, si të jetë e përshtatshme për produktin:

Për cikle larje shtëpiake ISO 6330 ose cikle lavanderie komerciale EN ISO 10528, të dyja në kombinim me EN ISO 12138. Kur tekstili nuk mund të hiqet BS 5651 ose ekuivalent.

25.c) Përkujdesje/mirëmbajtje lehtë (gjithashtu, referuar si parrudha ose hekurosje e përhershme)

Produktet me fibrat natyrore do të arrijnë një butësi/lëmim pëlhure shkalla SA-3 dhe produktet me fibra të përziera natyrore dhe sintetike një shkallë butësie/lëmimi SA-4 pas 10 larjesh shtëpiake dhe cikle tharje tumble në 40°C.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë raporte nga testime të kryera në përputhje me ISO 7768, metoda e testimit për vlerësimin e pamjes së jashtme të butësisë të pëlhurave pas larjes.

5. KRITERET E PËRGJEGJËSISË SO-CIALE TË KORPORATAVE

Kriteret në këtë seksion zbatohen për fazat e prerjes/bërjes/përshtatjes të prodhimit të produkteve tekstile.

Kriteri 26. Parime thelbësore dhe të drejtat në punë

Aplikantët do të sigurojnë që parimet thelbësore dhe të drejtat në punë, siç janë përshkruar në Standardet Thelbësore të Punës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), do të vëzhgohen nga të gjitha vendndodhjet e prodhimit të prerjes /bërjes/përshtatjes, të përdorura për të prodhuar produktin (produktet

e licencuara). Për qëllim të verifikimit, do bëhet referencë te Standardet Thelbësore të Punës ILO të mëposhtme:

- 029 Puna e detyruar;
- 087 Liria e shoqërive dhe mbrojtja e të drejtës për të organizuar;
- 098 E drejta për të organizuar dhe marrëveshjet kolektive;
- 100 Shpërblim i barabartë;
- 105 Heqja e punës së detyruar;
- 111 Diskriminimi (punësimi dhe profesioni);
- 155 Siguria dhe shëndeti i profesionit;
- 138 Konventa për Moshën Minimale;
- 182 Eliminimi i formave më të këqija për punën e fëmijëve.

Këto standarde do të komunikohen në vendndodhjet e prodhimit të prerjes /bërjes/përshtatjes, të përdorura për prodhimin e produktit përfundimtar.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të vërtetojë verifikim përputhshmërie të palës së tretë, duke përdorur verifikim të pavarur ose evidenca dokumentuese, duke përfshirë vizitat në vendndodhje nga audituesit gjatë procesit të verifikimit të ekoetiketës, për vendndodhjet e prodhimit të prerjes/bërjes/përshtatjes, në zinxhirin e furnizimit për produktet të tyre të licencuara. Kjo do të zhvillohet me aplikimin dhe më pas gjatë periudhës së licencës nëse futen vendndodhje të reja prodhimi.

Kriteri 27. Kufizimi i *sandblasting* të xhinseve

Përdorimi i *sandblasting*, manual ose mekanik, për të arritur finitura xhinsesh *distressed* nuk do të lejohen.

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë detaje të të gjitha vendndodhjeve të prodhimit të përdorura për të prodhuar produkte xhinsesh të ekoetiketuara së bashku me evidenca të dokumentuara dhe të fotografuara të proceseve alternative të përdorura për të arritur finitura xhinsesh *distressed*.

Kriteri 28. Informacioni që shfaqet në Ekoetiketë

Etiketa opsionale me kuadratin e tekstit mund të përmbajë formulime të përzgjedhura nga sa më poshtë:

- prodhim fibrash më i qëndrueshëm (ose tekst të zgjedhur nga tabela 11 më poshtë);
- procese prodhimi më pak ndotëse;
- kufizime mbi substancat e rrezikshme;
- i testuar për qëndrueshmëri.

Tabela 11

Teksti mund të shfaqet në krah të ekoetiketës në varësi të përmbajtjes së produktit

Fibra e përdorura	Specifikimi i prodhimit	Teksti që mund të shfaqet
Fibra pambuku	Përmbajtje organike më shumë se 50%	Bërë me xx % pambuk organik
	Përmbajtje organike më shumë se 95%	Bërë me pambuk organik
	Përmbajtje IPM më shumë se 70%	Pambuk i rritur me pesticide të reduktuara
Fibra celuloze të bërë nga njerëzit	Brumë i qëndrueshëm i certifikuar për më shumë se 25%	Bërë duke përdorur xx % dru nga pyje të qëndrueshme
	Brumë i qëndrueshëm i certifikuar për më shumë se 95%	Bërë duke përdorur dru nga pyje të qëndrueshme
Poliamid	Përmbajtje e ricikluar më shumë se 20%	Bërë me xx % najlon të ricikluar
	Përmbajtje e ricikluar më shumë se 95%	Bërë me najlon të ricikluar
Poliester	Përmbajtje e ricikluar më shumë se 50%	Bërë me xx % poliester të ricikluar
	Përmbajtje e ricikluar më shumë	Bërë me poliester të ricikluar

Vlerësimi dhe verifikimi: aplikanti do të ofrojë një mostër të paketimit të produktit duke treguar etiketën, së bashku me një deklaratë përputhshmërie me këtë kriter.

SHTOJCA 1

LISTA E SUBSTANCAVE TË KUFIZUARA TË EKOETIKETËS TË TEKSTILEVE

Lista e substancave të kufizuara RSL e ekoetiketës konsiston në kufizime që zbatohen për fazat e mëposhtme të prodhimit në zinxhirin e furnizimit të tekstileve:

- a) tjerre fibrash dhe fijesh;
- b) zbardhimi dhe para trajtimit;
- c) fabrikat/punishtet e ngjyrosjes;
- d) proceset e stampimit;
- e) proceset e përfundimit/finiturat;
- f) të gjitha fazat e prodhimit;
- g) produkti përfundimtar.

Një numër kufizimesh nën pikën “g” zbatohen, gjithashtu, për produktin përfundimtar, për të cilin mund të kërkohet testim analitik.

- a) Kufizimet që zbatohen për tjerren e fibrave dhe fijeve dhe endjen/thurjen

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
<p>i) përgatitje e përmasave që zbatohen për fibrat dhe fijet</p> <p>Zbatueshmëria: Proceset e tjerjes</p>	<p>Të paktën 95% (me peshë të thatë) e substancave përbërëse, do të jenë lehtësisht të biodegradueshme.</p> <p>Në të gjitha rastet shuma e çdo komponenti/përbërësi do të merret në konsideratë.</p>	<p>Lehtësisht të biodegradueshme: 70% degradim të karbonik organik të tretur brenda 28 ditëve</p> <p>Ose 60% e shterimit teorik të oksigjenit maksimal ose gjenerimit të dyoksidit të karbonit brenda 28 ditëve.</p>	<p>Verifikimi: Deklaratë nga furnizuesi i kimikateve, e mbështetur nga rezultatet e testimit OECD ose ISO.</p> <p>Metoda e testimit: OECD 301 A, ISO 7827 OECD 301 B, ISO 9439 OECD 301 C, (2) OECD 301 D, ISO 10708 OECD 301 E, OECD 301 F, ISO 9408</p>
<p>ii) tjerja e aditivëve tretësirë/solucion, tjerja e aditivëve dhe agjentëve të përgatitjes (duke përfshirë vajra krehje, produkte finiture dhe lubrifikantë)</p> <p>Zbatueshëm</p> <p>Zbatueshmëria: Proceset kryesore të tjerjes.</p>	<p>Të paktën 95% (me peshë të thatë) e substancave përbërëse do të jenë lehtësisht te biodegradueshme, natyrshëm të biodegradueshme ose të eliminueshme në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.</p> <p>Në të gjitha rastet shuma e çdo komponenti/përbërësi do të merret në konsideratë.</p>	<p>Lehtësisht të biodegradueshme: Shih përkufizimin në (a) (ii)</p> <p>Natyrshëm të biodegradueshme: 70% degradim të karbonik organik të tretur brenda 28 ditëve</p> <p>Ose 60% e shterimit teorik të oksigjenit maksimal ose gjenerimit të dyoksidit të karbonit brenda 28 ditëve.</p> <p>Eliminimi: 80% e degradimit të karbonik organik të tretur brenda 28 ditëve.</p>	<p>Verifikimi: Deklaratë nga furnizuesi i kimikateve, e mbështetur nga rezultatet e testimit OECD ose ISO.</p> <p>Metoda e testimit: Shih (a)(ii) për testimet lehtësisht të biodegradueshme.</p> <p>Pranohen gjithashtu, testimet natyrshëm të biodegradueshme: ISO 14593 OECD 302 A, ISO 9887, OECD 302 B, ISO 9888 OECD 302 C, Testet për eliminimin: OECD 303A/B ISO 11733</p>

b) Kufizimet që zbatohen për zbardhjen

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
<p>Zbardhja e fijeve, pëlhurave dhe produktet e përfundimit (end)</p> <p>Zbatueshmëria: të gjitha llojet e fibrave</p>	<p>Agjentët e klorurit nuk do të përdoren për zbardhjen e ndonjë fije, pëlhure, panele të thurura ose produkte të përfundimit me përjashtim të fibrave celuloze të bëra nga njerëzit.</p>	<p>Jo e aplikueshme</p>	<p>Verifikimi: Deklarimi i mos-përdorimit nga faza (fazat) e prodhimit.</p>

c) Kufizime që zbatohen për fabrikat/punishtet e ngjyrosjes

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
---------------------------	----------------------------	--------------------	-------------------------------

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
i) Transportuesit e halogjenizuar Zbatueshmëria: Poliester, përzierje poliestër-lesh, akrilik dhe poliamid kur përdoren ngjyruet të shpërndarë	Akseleruesit ngjyrosës të halogjenizuar (transportuesit) nuk do të përdoren për të ngjyrosur fibra sintetike dhe pëlhura ose përzierje poliestër-lesh. Shembuj të transportuesve përfshijnë 1,2-dichlorobenzene, 1,2,4-trichlorobenzene, chlorophenoxyethanol.	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklarimi i mos-përdorimit nga furnizuesi i kimikateve të mbështetur nga SDS.
ii) Ngjyruet azo Zbatueshmëria: aplikimi i ngjyrave nga shtojca 2 për akrilikun, pambukun, poliamidin, fibrat e leshit, punime shtize dhe pëlhura.	Ngjyruet azo, që mund të lidhen ngushtë me aminat aromatike që njihen që janë kancerogjene, nuk do të përdoren. Shtojca 2 përmban një listë të aryl aminave të kufizuara dhe një listë treguese të ngjyruëve që mund të lidhen ngushtë me këto aryl amina. Kjo e fundit do të përdoret si një guidë për ngjyruet që nuk duhet të përdoren. Vlera kufi për aryl aminat do të zbatohet për produktin përfundimtar.	30 mg/kg për çdo amine (!)	Verifikimi: Testimi i produktit përfundimtar do të kryhet siç është specifikuar. Metoda e testimit: EN 14362-1 dhe 3.
iii) Ngjyruet CMR Zbatueshmëria: Të gjitha produktet	Ngjyruet, që janë kancerogjen, mutagjen ose toksik për riprodhimin, nuk do të përdoren. Shtojca 2 përmban një listë të ngjyruëve CMR që nuk do të përdoren	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklarimi i mos-përdorimit nga furnizuesi i kimikateve të mbështetur nga SDS.
iv) ngjyruet potencialisht të ndjeshëm Zbatueshmëria: Poliester, - akrilik, - poliamid. Veshje ose të brendshme elastike ose të ngjitura pas trupit.	Ngjyruet që janë potencialisht të ndjeshëm nuk do të përdoren. Shtojca 2 përmban një listë që përmban ngjyruet e ndjeshëm që nuk do të përdoren.		Verifikimi: Deklarimi i mos-përdorimit nga furnizuesi i kimikateve të mbështetur nga SDS.
v) Ngjyruet fiksues (mordant) kromi Zbatueshmëria: leshi, poliamid	Ngjyruet fiksues kromi nuk do të përdoren	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklarimi i mos-përdorimit nga furnizuesi i kimikateve të mbështetur nga SDS
vi) ngjyruet me metal kompleks Zbatueshmëria: Poliamid, lesh, fibra celulozë	Ngjyruet me metal kompleks bazuar në bakër, krom dhe nikel, do të lejohen vetëm për të ngjyrosur: - fibra leshi; - fibra poliamide; - përzierje leshi dhe/ose poliamide	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklarimi i mos-përdorimit nga furnizuesi i kimikateve të mbështetur nga SDS

¹ Duhet të merren masa për të evituar pozitivet fallso nga prania e 4-aminoazobenzene.

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
	me fibra celuloze të bëra nga njerëzit.		

d) Kufizimet që zbatohen për proceset e stampimit

Printimi

i) Ngjyruetit dhe pigmentet	Ngjyruetit dhe pigmentet e përdorur për të printuar/stampuar tekstilet e ekoetiketuara do të jenë në përputhshmëri me kufizimet që zbatohen për punishtet e ngjyrosjes (seksioni C i kësaj shtojce)	Ju lutemi referohuni te kufizimet e punishteve/fabrikave të ngjyrosjes (seksioni C)	Verifikimi: Siç specifikohet për punishtet e ngjyrosjes
ii) Xheli/brumi i stampimit Zbatueshmëria: Kur aplikohet stampimi	Xheli/brumi i stampimit i përdorur nuk do të përmbajë më shumë se 5% të komponimeve organike të paqëndrueshme (VOC). Këto mund të përfshijnë: - hidrokarbon alifatik (C10 — C20); - monomer, të tillë si: akrilite, acetat vinili, styrene; - monomer, të tillë si: akrilonitrile, akrilamid, butadien; - alkolet, esteret, polyols; - formaldehide; - ester acid fosforik; - benzen si papastërti nga hidrokarbonet e sipërme; - amonia (p.sh. dekompozimi ureas, veprimi/reagimi biuret).	< 5,0 % w/w përmbajtja VOC	Verifikimi: Deklaratë nga aplikanti që nuk është bërë asnjë stampim Ose Deklaratë nga stampuesi të mbështetur nga SDS dhe/ose llogaritjet për xhelin e stampimit
iii) Lidhësit plastisol Zbatueshmëria: kur aplikohet stampim	Aditivët “plastisol” për të printuar lidhës, duke përfshirë PVC dhe ftalate të kufizuara, nuk do të përdoren.	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë nga aplikanti që nuk është bërë asnjë stampim Ose Deklaratë për mos-përdorim nga furnizuesit e kimikateve të mbështetur nga SDS për aditivët.

e) Kufizime që zbatohen për proceset e përfundimit

Finitura, trajtime dhe aditivëve funksional

i) Finitura biocide të përdorura për të dhënë karakteristika biocide për produktet përfundimtare. Zbatueshmëria: Të gjitha produktet	Biocidet nuk do të inkorporohen në fibra, pëlhura apo në produktin përfundimtar në mënyrë që të japin karakteristika biocide. Shembuj të zakonshëm përfshijnë triklosan, nano-argjend, komponime organike zinku, komponime organike kallaj, komponimet diklorofenil(ester), derivatet e benzimidazol dhe isothiazolinones.	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë për mospërdorim nga aplikanti
ii) Antifeltindhe rezistente ndaj tkurrjes/ngushtim	Substancat e halogjenizuara ose preparatet do të aplikohen vetëm për pjesë leshi dhe lesh të larë të lirshëm	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë për mospërdorim nga përpunuesit e leshit.

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
Zbatueshmëria: Kur aplikohet			
iii) Trajtime të substancave rezistente ndaj ujit, njollave dhe vajit. Zbatueshmëria: Kur aplikohet për të ofruar funksionin	Trajtime të substancave rezistente ndaj ujit, njollave dhe vajit të fluorinuara nuk do të përdoren. Këto do të përfshijnë trajtimet e perfluorinuara dhe polifluorinuara. Trajtimet jo të fluorinuara do të jenë lehtësisht të biodegradueshme dhe jo bioakumulative në mjedisin ujor duke përfshirë sedimentin ujor. Për më tepër ato do të jenë në përputhshmëri me kriteret e përshtatshme për përdorim 25 (a).	Jo e aplikueshme	Verifikim: Deklaratë për mospërdorim të mbështetur nga SDS për substancat rezistente, të përdorur për t'u ofruar nga përfunduesit. Metoda e testimit: Jo e aplikueshme
iv) Ngadalësuesit e flakës Zbatueshmëria: Kur aplikohet dhe siç specifikohet për synergists	Ngadalësuesit e mëposhtëm të flakës nuk do të përdoren: HBCDD — Hexabromocyclododecane PeBDE — Pentabromodiphenyl ether OcBDE — Octabromodiphenyl ether DecaBDE — Decabromodiphenyl ether PBBs — bifenile të Polibrominuara TEPA—Tris(aziridinyl) phosphin oxide TRIS—Tris (2,3 dibromopropyl)fosfat TCEP — Tris (2, chloroethyl)phosphate Paraffin, C10-C13, klorinuar (SCCP)	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë për mospërdorim të mbështetur nga SDS.
	Synergist trioksid antimoni (H351) është përjashtuar nga përdorimi si synergist për veshjen e pjesës së mbrapme të tekstileve të brendshme, vetëm me kushtin që produktit i kërkohet të jetë ngadalësues flake dhe që përmbushen vlerat kufi të ekspozimit në vendin e punës të profesionit.	Tetë orë vlera mesatare e turnit ELV për 0,50 mg/m ³	Verifikimi: Të dhënat e monitorimit do të ofrohen nga përfunduesi kur aplikohet trioksidi i antimonit.

f) Kufizime që zbatohen për të gjitha fazat e prodhimit

Substanca me rrezikshmëri të lartë (SVHC)

i) Substancat që janë futur në listën kandidatë ECHA Zbatueshmëria: Të gjitha produktet		Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë përputhshmërie nga secila fazë prodhimi dhe furnizuesit e tyre të kimikateve.
--	--	------------------	--

Surfaktantët, zbutësit dhe agjentët kompleksues

ii) Të gjithë surfaktantët, zbutësit e pëlhurave dhe agjentët	Të paktën 95% në peshë të zbutësve të pëlhurave, agjentëve kompleksues dhe surfaktantëve do të jenë: - lehtësisht të biodegradueshme nën	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë e furnizuesit të kimikateve e mbështetur nga SDS
---	---	------------------	---

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
kompleksues. Zbatueshmëria: Të gjitha proceset e lagështa	kushte aerobike; ose - natyrshëm të biodegradueshëm dhe/ose - të eliminueshme në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.		dhe/ose rezultatet e testimit OECD ose ISO. Metoda e testimit: Shih përmasat dhe agjentët e tjerres (shtojca 1(a)i/ii)
(iii) Surfaktantët jojonik dhe katonik Zbatueshmëria: Për të gjitha proceset e lagështa	Të gjithë surfaktantët jojonikë dhe katonikë do të jenë lehtësisht të biodegradueshëm nën kushte anaerobike.	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë nga SDS dhe/ose furnizuesi i kimikateve të mbështetur nga rezultatet e testimit OECD ose ISO Metoda e testimit: EN ISO 11734, ECETOC No 28 OECD 311

Substanca me problematikë të lartë (SVHC)

Ndihmëse

iv) Produktet ndihmëse të përdorura në preparate dhe formulime. Zbatueshmëria: Të gjitha produktet.	Substancat e mëposhtme nuk do të përdoren në asnjë preparat ose formulime të përdorura për tesktilet dhe që janë subjekt i vlerave kufi për praninë e substancave mbi produktin përfundimtar. Nonylphenol, izomerë të përzier 25154-52-3 4-Nonylphenol 104-40-5 4- Nonylphenol, të degëzuar 84852-15-3 Octylphenol 27193-28-8 4- Octylphenol 1806-26-4 4-tert-Octylphenol 140-66-9 Alkylphenolethoxylates (APEOs) dhe derivatet e tyre: Polyoxyethylated octyl phenol 9002-93-1 Polyoxyethylated nonyl phenol 9016-45-9 Polyoxyethylated p-nonyl phenol 26027-38-3	25 mg/kg shuma totale	Verifikimi: Testimi i produktit përfundimtar do të kryhet siç specifikohet për alkifenolët. Metoda e testimit: Ekstraktim i solventëve të ndjekur nga LCMS-ja.
	Substancat e mëposhtme nuk do të përdoren në ndonjë preparat apo formulim tekstil: bis(hydrogenated tallow alkyl) dimethyl ammonium chloride (DTDMAC) distearyl dimethyl ammonium chloride (DSDMAC) di(hardened tallow) dimethyl ammonium chloride (DHTDMAC)	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë e mospërdorimit nga furnizuesit e kimikateve të mbështetur nga SDS për të gjitha fazat e prodhimit.

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
	ethylene diamine tetra acetate (EDTA), diethylene triamine penta acetate (DTPA) 4-(1,1,3,3-tetramethylbutyl)phenol 1-Methyl-2-pyrrolidone Nitrilotriacetic acid (NTA)		
g) kufizimet që zbatohen për produktin përfundimtar			
i) Lista kandidat e SVHC-ve që janë përjashtuar. Zbatueshmëria: Elastane, akrilik	N,N-Dimethylacetamide (127-19-5) Vlerat kufi të mëposhtme do të zbatohen për të përfunduar produkte që përmbajnë elastane dhe akrilik:		Verifikimi: Testimi i produktit përfundimtar. Metoda e testimit: Ekstraktim solventi, GCMS ose LCMS
	- Produkte për fëmijë nën 3 vjeç	0,001 % w/w	
	- Produkte që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me lëkurën	0,005 % w/w	
	- Veshje me kontakt të kufizuar me lëkurën dhe tekstilet e brendshme	0,005 % w/w	
ii) Mbetje të Formaldehyde. Zbatueshmëria: Të gjitha produktet. Kushtet specifike zbatohen për veshje me finitura të lehta për mirëmbajtje (referuar, gjithashtu, si pa rrudhosje ose hekurosje e përhershme).	Vlerat kufi të mëposhtme do të zbatohen për mbetje të Formaldehyde nga finitura të lehta për mirëmbajtje		Verifikimi: Testimi i produktit përfundimtar për produkte me finitura të lehta për mirëmbajtje. Një deklaratë për mospërdorim kërkohet për të gjitha produktet e tjera. Metoda e testimit: EN ISO 14184-1
	- Produkte për fëmijë nën 3 vjeç	16 ppm	
	- Produkte që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me lëkurën	16 ppm	
	- Veshje me kontakt të kufizuar me lëkurën dhe tekstilet e brendshme	75 ppm	
iii) Biocidet e përdorura për të mbrojtur tekstilet gjatë transportimit dhe ruajtjes(magazinimit) Zbatueshmëria: Për të gjitha produktet	Vetëm biocidet që janë autorizuar sipas legjislacionit në fuqi lejohen për përdorim. Janë kufizuar biocidet specifike të mëposhtme: - Klorofenolet (kripërat dhe esterët e tyre); - Bifenile të poliklorinuara (PCB); -Komponimet organotin, duke përfshirë TBT, TPhT, DBT dhe DOT; - Dimethyl fumarate (DMFu).	Jo e aplikueshme	Verifikimi: Deklaratë për mospërdorim përpara transportimit dhe magazinimit të mbështetur nga SDS.
iv) Metale të ekstraktueshme Zbatueshmëria: Të gjitha produktet me vlera kufi të ndryshme që aplikohen për foshnja dhe fëmijë	Vlerat kufi të mëposhtme zbatohet për produktet të synuara për foshnja dhe fëmijë nën 3 vjeç:	mg/kg	Verifikimi: Testimi i produktit përfundimtar. Metoda e testimit: Ekstraktim – EN ISO 105-E04-2013 (solucion acid djerse)
	Antimon (Sb)	30,0	
	Arsenik (As)	0,2	
	Kadmium (Cd)	0,1	
	Krom (Cr)		
- Tekstile të ngjyrosura me ngjyrosës	1,0		

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
nën 3 vjeç.	me metal kompleks		Zbulimi - MS ose ICP-OES
	- Të gjitha tekstile e tjera	0,5	
	Kobalt (Co)	1,0	
	Bakër (Cu)	25,0	
	Plumb (Pb)	0,2	
	Nikel (Ni)		
	- Tekstile të ngjyrosura me ngjyrosës me metal kompleks	1,0	
	- Të gjitha tekstile e tjera	0,5	
	Merkur (Hg)	0,02	
	Vlerat kufi të mëposhtme zbatohen për të gjitha produktet e tjera duke përfshirë tekstile të brendshme	mg/kg	Verifikimi: Testimi i produktit përfundimtar.
	Antimon (Sb)	30,0	
	Arsenik (As)	1,0	Metoda e testimit: Ekstraktim – EN ISO 105-E04-2013 (solucion acid djerse)
	Kadmium (Cd)	0,1	
	Krom (Cr)		
	- Tekstile të ngjyrosura me ngjyrosës me metal kompleks	2,0	
	- Të gjitha tekstilet e tjera	1,0	Zbulimi - MS ose ICP-OES
	Kobalt (Co)		
	- Tekstile të ngjyrosura me ngjyrosës me metal kompleks	4,0	
	- Të gjitha tekstilet e tjera	1,0	
	Bakër (Cu)		
Plumb (Pb)	50,0		
Nikel (Ni)	1,0		
Merkur (Hg)	1,0 0,02		
v) Veshjet, laminatet dhe membranat Zbatueshmëria: Kur inkorporohen në strukturën tekstile.	Polimerët nuk do të përmbajnë ftalatet e mëposhtme: DEHP (Bis-(2-ethylhexyl)-phthalate) BBP (Butylbenzylphthalate) DBP (Dibutylphthalate) DMEP (Bis2-methoxyethyl phthalate) DIBP (Diisobutylphthalat) DIHP (Di-C6-8-branched alkylphthalates) DHNUP (Di-C7-11-branched alkylphthalates) DHP (Di-n-hexylphthalate)	Shuma totale 0,10 % w/w	Verifikimi: Deklaratë për mospërdorim nga prodhuesi i polimerit të mbështetur nga SDS për plastifikuesit e përdorur në formulim. Kur informacioni nuk është i disponueshëm, mund të kërkohet testim. Metoda e testimit: EN ISO 14389
	Membranat fuloropolimer dhe laminatet mund të përdoren për veshje të jashtme dhe veshje teknike të jashtme. Ato nuk do të prodhohen duke përdorur PFOA		Verifikimi: Deklaratë përputhshmërie nga prodhuesi i membranave ose laminateve në lidhje me

Grupi i substancës	Qëllimi i kufizimit	Vlerat kufi	Kërkesat e verifikimit
	apo ndonjë nga homologet e tij të larta sipas përkufizimit nga OECD.		prodhimin e polimerëve.
v) Aksesorëte tillë, si: kopsat, përcina dhe zinxhirë Zbatueshmëria: Kur inkorporohen në strukturën e veshjeve	Për aksesorët metalikë:		Verifikimi: Testimi i përbërjes të komponentëve metalikë. Metodat e testimit: Për migrimin e nikelit EN 12472-2005 EN 1811-1998+A1-2008 Metale të tjera Zublim - GC-ICP-MS
	Një limit migrimi do të zbatohet për aliazhe metali që përmbajnë nikel që janë kontakt të drejtpërdrejtë ose të zgjatur me lëkurën.	Nikel 0,5 µg/ cm ² /javë	
	Testime shtesë do të kryhen për praninë e metaleve të mëposhtme, për të cilët do të zbatohen vlerat kufi:		
	Plumbi (Pb)	90 mg/kg	
	Kadmimum (Cd)		
	- produktet e synuara për fëmijë nën 3 vjeç	50 mg/kg	
	- të gjitha produktet e tjera duke përfshirë tekstilet e brendshme	100 mg/kg	
	Korm (Cr) kur ka krom plating(kromatur)	60 mg/kg	
Merkur (Hg)	60 mg/kg		
Ftalatet e mëposhtme nuk do të përdoren në asnjë aksesorë plastik: - DEHP (Bis-(2-ethylhexyl)-phthalate) - BBP (Butylbenzylphthalate) - DBP (Dibutylphthalate) - DMEP (Bis2-methoxyethyl) phthalate - DIBP (Diisobutylphthalate) - DIHP (Di-C6-8-branched alkylphthalates) - DHNUP (Di-C7-11-branched alkylphthalates) - DHP (Di-n-hexylphthalate) Ftalatet e mëposhtme nuk do të përdoren në veshjet e fëmijëve kur ka rrezik që aksesorë mund të vendoset në gojë p.sh zinxhirët e dorezave: - DINP (Di-isononyl phthalate) - DIDP (Di-isodecyl phthalate) - NOP (Di-n-Octyl phthalate)	Jo e aplikueshme	Verifikimi: SDS do të ofrohet për formulimin plastik.	

SHTOJCA 2
KUFIZIMET E NGJYRUESVE

a) Amina aromatike kancerogjene

Aryl amina	Numri CAS
4-aminodiphenyl	92-67-1
Benzidine	92-87-5
4-chloro-o-toluidine	95-69-2
2-naphthylamine	91-59-8

o-amino-azotoluene	97-56-3
2-amino-4-nitrotoluene	99-55-8
4-chloroaniline	106-47-8
2,4-diaminoanisol	615-05-4
4,4'-diaminodiphenylmethane	101-77-9
3,3'-dichlorobenzidine	91-94-1
3,3'-dimethoxybenzidine	119-90-4
3,3'-dimethylbenzidine	119-93-7
3,3'-dimethyl-4,4'-diaminodiphenylmethane	838-88-0
p-cresidine	120-71-8
4,4'-methylene-bis-(2-chloro-aniline)	101-14-4
4,4'-oxydianiline	101-80-4
4,4'-thiodianiline	139-65-1
o-toluidine	95-53-4
2,4-diaminotoluene	95-80-7
2,4,5-trimethylaniline	137-17-7
4-aminoazobenzene	60-09-3
o-anisidine	90-04-0
2,4-Xylidine	95-68-1
2,6-Xylidine	87-62-7

b)Lista treguese e ngjyruesve që mund të lidhen ngushtë me aminat aromatike kancerogjene

Ngjyra shpërndarëse

Portokalli shpërndarëse 60	E verdhë shpërndarëse 7
Portokalli shpërndarëse 149	E verdhë shpërndarëse 23
E kuqe shpërndarëse 151	E verdhë shpërndarëse 56
E kuqe shpërndarëse 221	E verdhë shpërndarëse 218

Ngjyrues bazë

Kafe bazë 4	E kuqe bazë 114
E kuqe bazë 42	E verdhë bazë 82
E kuqe bazë 76	E verdhë bazë 103
E kuqe bazë 111	

Ngjyrues acid

E zezë acid CI 29	E kuqe acid 24	E kuqe acid 128
E zezë acid CI 94	E kuqe acid 26	E kuqe acid 115
E zezë acid CI 131	E kuqe acid 26:1	E kuqe acid 128
E zezë acid CI 132	E kuqe acid 26:2	E kuqe acid 135
E zezë acid CI 209	E kuqe acid 35	E kuqe acid 148
E zezë acid CI 232	E kuqe acid 48	E kuqe acid 150
	E kuqe acid 73	E kuqe acid 158
	E kuqe acid 85	E kuqe acid 167
	E kuqe acid 104	E kuqe acid 170
	E kuqe acid 114	E kuqe acid 264
	E kuqe acid 115	E kuqe acid 265

	E kuqe acid 116	E drejtpërdrejtë acid 420
	E kuqe acid 119:1	Vjollcë acid CI 12
Ngjyra të drejtpërdrejta		
E zezë e drejtpërdrejtë 4	Kafe bazë 4	E kuqe e drejtpërdrejtë 13
E zezë e drejtpërdrejtë 29	Kafe e drejtpërdrejtë 6	E kuqe e drejtpërdrejtë 17
E zezë e drejtpërdrejtë 38	Kafe e drejtpërdrejtë 25	E kuqe e drejtpërdrejtë 21
E zezë e drejtpërdrejtë 154	Kafe e drejtpërdrejtë 27	E kuqe e drejtpërdrejtë 24
Blu e drejtpërdrejtë 1	Kafe e drejtpërdrejtë 31	E kuqe e drejtpërdrejtë 26
Blu e drejtpërdrejtë 2	Kafe e drejtpërdrejtë 33	E kuqe e drejtpërdrejtë 22
Blu e drejtpërdrejtë 3	Kafe e drejtpërdrejtë 51	E kuqe e drejtpërdrejtë 28
Blu e drejtpërdrejtë 6	Kafe e drejtpërdrejtë 59	E kuqe e drejtpërdrejtë 37
Blu e drejtpërdrejtë 8	Kafe e drejtpërdrejtë 74	E kuqe e drejtpërdrejtë 39
Blu e drejtpërdrejtë 9	Kafe e drejtpërdrejtë 79	E kuqe e drejtpërdrejtë 44
Ngjyra shpërndarëse		
Blu e drejtpërdrejtë 10	Kafe e drejtpërdrejtë 95	E kuqe e drejtpërdrejtë 46
Blu e drejtpërdrejtë 14	Kafe e drejtpërdrejtë 101	E kuqe e drejtpërdrejtë 62
Blu e drejtpërdrejtë 15	Kafe e drejtpërdrejtë 154	E kuqe e drejtpërdrejtë 67
Blu e drejtpërdrejtë 21	Kafe e drejtpërdrejtë 222	E kuqe e drejtpërdrejtë 72
Blu e drejtpërdrejtë 22	Kafe e drejtpërdrejtë 223	E kuqe e drejtpërdrejtë 126
Blu e drejtpërdrejtë 25	Jeshile e drejtpërdrejtë 1	E kuqe e drejtpërdrejtë 168
Blu e drejtpërdrejtë 35	Jeshile e drejtpërdrejtë 6	E kuqe e drejtpërdrejtë 216
Blu e drejtpërdrejtë 76	Jeshile e drejtpërdrejtë 8	E kuqe e drejtpërdrejtë 264
Blu e drejtpërdrejtë 116	Jeshile e drejtpërdrejtë 8.1	Vjollcë e drejtpërdrejtë 1
Blu e drejtpërdrejtë 151	Jeshile e drejtpërdrejtë 85	Vjollcë e drejtpërdrejtë 4
Blu e drejtpërdrejtë 160	Portokalli e drejtpërdrejtë 1	Vjollcë e drejtpërdrejtë 12
Blu e drejtpërdrejtë 173	Portokalli e drejtpërdrejtë 6	Vjollcë e drejtpërdrejtë 13
Blu e drejtpërdrejtë 192	Portokalli e drejtpërdrejtë 7	Vjollcë e drejtpërdrejtë 14
Blu e drejtpërdrejtë 201	Portokalli e drejtpërdrejtë 8	Vjollcë e drejtpërdrejtë 21
Blu e drejtpërdrejtë 215	Portokalli e drejtpërdrejtë 10	Vjollcë e drejtpërdrejtë 22
Blu e drejtpërdrejtë 295	Portokalli e drejtpërdrejtë 108	E verdhë e drejtpërdrejtë 1
Blu e drejtpërdrejtë 306	E kuqe e drejtpërdrejtë 1	E verdhë e drejtpërdrejtë 24
Kafe e drejtpërdrejtë 1	E kuqe e drejtpërdrejtë 2	E verdhë e drejtpërdrejtë 48
Kafe e drejtpërdrejtë 1:2	E kuqe e drejtpërdrejtë 7	
Kafe e drejtpërdrejtë 2	E kuqe e drejtpërdrejtë 10	

c) Ngjyra që janë CMR ose që janë potencialisht të ndjeshme

Ngjyra që janë kancerogjene, mutagen ose toksike për riprodhimin

E kuqe acid C.I. 26	E zezë e drejtpërdrejtë C.I. 38	Blu e shpërndarë C.I. 1
E kuqe bazë C.I. 9	Blu e drejtpërdrejtë C.I. 6	Portokalli e shpërndarë C.I. 11
Vjollcë bazë C.I. 14	E kuqe e drejtpërdrejtë C.I. 28	E verdhë e shpërndarë C.I. 3

Ngjyra të shpërndara që janë potencialisht të ndjeshme

Blu e shpërndarë C.I. 1	Blu e shpërndarë C.I. 124	E kuqe e shpërndarë C.I. 11
Blu e shpërndarë C.I. 3	Kafe e shpërndarë C.I. 1	E kuqe e shpërndarë C.I. 17
Blu e shpërndarë C.I. 7	Portokalli e shpërndarë C.I. 1	E verdhë e shpërndarë C.I. 1
Blu e shpërndarë C.I. 26	Portokalli e shpërndarë C.I.3	E verdhë e shpërndarë C.I. 3
Blu e shpërndarë C.I. 35	Portokalli e shpërndarë C.I. 37	E verdhë e shpërndarë C.I. 9
Blu e shpërndarë C.I. 102	Portokalli e shpërndarë C.I. 76	E verdhë e shpërndarë C.I. 39
Blu e shpërndarë C.I. 106	E kuqe e shpërndarë C.I. 1	E verdhë e shpërndarë C.I. 49